

Divizioni për Sigurim të Cilësisë, Standarde, Vlerësim dhe Licencim



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Ministarstva za Obrazovanje i Nauku

Ministry of Education and Science

**UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE
NË VITIN SHKOLLOR 2020/2021 NË KUSHTET
E PANDEMISË COVID 19**

Prishtinë, 2020

Kontribuesit që morën pjesë në rishikimin e Udhëzuesit për vlerësimin e nxënësve në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID 19.

Grupi punues:

Feime Llapashtica – Lipscom, Fatmir Elezi, Nizafete Kutllovci – Bardhi, Mirlinda Dehari – Zeka, Luan Kryeziu, Linda Ukimeraj, Selim Mehmeti, Osman Buleshkaj, Labëri Luzha, Lulavere Behluli, Blerim Saqipi.

Përmbajtja

HYRJE 1

1 PARIMET E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE, NË KUSHTET E PANDEMISË COVID 19 4

Mirëqenia e fëmijëve/nxënësve (shëndeti mendor dhe përkrahja psikosociale) 4

Vlerësimi formues ka përparësi në raport me vlerësimin përmbledhës 4

Sjellja etike 5

Mbështetja në normat ligjore 6

Kujdesi për kategoritë e cënueshme 6

2 VLERËSIMI I NXËNËSVE SIPAS KËRKESAVE TË KURRIKULËS DHE SKENARËVE TË ORGANIZIMIT TË VITIT SHKOLLOR 2020/2021, NË KUSHTET E PANDEMISË COVID 19 7

2.1 Vlerësimi i nxënësve sipas skenarit A të organizimit të mësimit 10

2.2 Vlerësimi i nxënësve sipas skenarit B të organizimit të mësimit 12

2.3 Vlerësimi i nxënësve sipas skenarit C të organizimit të mësimit 15

3 METODAT E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE NË KUSHTET E PANDEMISË COVID 19 17

3.1 Metodatat standarde 17

3.2 Metodatat/teknikat inovatore (kreative dhe ndërvepruese) 19

4 FORMAT E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE NË KUSHTET E PANDEMISË COVID 19 27

4.1 Vlerësimi diagnostifikues 28

4.2 Vlerësimi formativ 28

4.3 Vlerësimi përmbledhës 29

5 MODALITETET E VLERËSIMIT NË RASTE SPECIFIKE 30

5.1 Vlerësimi në nivelin pashakollor\parafillor 30

5.2 Vlerësimi në arsimin fillor 32

5.3 Vlerësimi në arsimin e mesëm të ulët 33

5.4 Vlerësimi në arsimin e mesëm të lartë 35

5.4.1 Vlerësimi në arsimin profesional 35

5.5 Vlerësimi në lëndët artistike 36

5.6 Vlerësimi i nxënësve me nevojë të veçanta 37

6 ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË VLERËSIMIN E NXËNËSVE NË KUSHTET E PANDEMISË COVID 19 39

6.1 Roli i MASH 39

6.2 Roli i DKA-së 40

6.3 Roli i komunitetit të shkollës 40

6.3.1 Roli i drejtorit të shkollës 40

6.3.2 Roli i mësuesit/mësimdhënësit 41

6.3.3 Roli i nxënësit 42

6.3.4 Roli i prindërve 42

6.4 Monitorimi dhe raportimi për vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë COVID 19 44

Shtojca 47

HYRJE

Në Kosovë procesi mësimor ka ndryshuar, për shkak të kushteve dhe rrethanave të krijuara nga pandemia me covid-19. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), në rrethanat e krijuara ka ndërmarrë masa për fillimin e vitit shkollor 2020/21, duke hartuar dokumente të cilat do t'ua lehtësojnë punën institucioneve arsimore, në këtë kontekst hartohet edhe dokumenti “Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve në vitin shkollor 2020/21 në kohë pandemie”, i cili është i mbështetur në Udhëzuesin e Përgjithshëm të hartuar nga MASH¹ për organizimin e mësimin në këtë vit shkollor dhe në dokumentin “Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë”², i hartuar në prill të vitit 2020.

Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve në vitin shkollor 2020/21, do të jep udhëzime më specifike për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar, sipas skenarëve për organizimin e mësimin të përcaktuar në Udhëzuesin e Përgjithshëm për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID 19.

Kur bëhet fjalë për vlerësimet janë dy nevoja kryesore që ndikojnë në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies.

- Së pari, është nevoja për të inkurajuar dhe mbështetur mësimin e nxënësve, duke ju ofruar përvojat më të mira të mundshme të të nxënësve për nxënësit në këto kushte të kufizuara dhe të kërkuara, gjithashtu duhet bërë ç'mos që të gjithë nxënësit të mësojnë mirë, të mos pengohen, por të ndihmohen në përparimin e tyre në procesin e të mësuarit.
- E dyta është nevoja për të dokumentuar dhe kuantifikuar mësimin e nxënësve për qëllime të evidencës së rezultateve për performancën e nxënësve (notat). Shkollat duhet të verifikojnë suksesin e nxënësve edhe për format alternative të mësimin. Nxënësve duhet t'u përshkruhet suksesi për rezultatet e tyre së bashku me raportin për përparësitë ose ngecjet e tyre. Kjo duhet të vlejë edhe për nxënësit me nevoja të veçanta si dhe për arsimin e të rriturve që ndjekin mësimet në vitet e caktuara të shkollimit.

Në fakt, MASH ka udhëzuar institucionet arsimore për tre skenarët e mundshëm për organizimin e procesit mësimor: skenari i parë procesi i mësimdhënies në shkollë me masa parandaluese anti COVID-19, skenari i dytë rikthim i pjesshëm, mësim i kombinuar (mësim në shkollë dhe në distancë), dhe skenari i tretë mësim në distancë (TV+e-mësimi).

Mësimi në shkollë – do të aplikohet kur niveli i rrezikshmërisë për infeksione është i ulët, nuk ka restriksione në lirinë e lëvizjes, prandaj mësimi do të organizohet me prezencë në institucionet parashkollore dhe shkollore me masa parandaluese për siguri dhe shëndet duke respektuar protokollat për COVID-19. Në të njëjtën mënyrë shkolla duhet të veprojnë për nxënësit me nevoja të veçanta edhe për arsimin e të rriturve. Procesin e vlerësimit të nxënësve do të zhvillohet poashtu në objektet arsimore duke respektuar dokumentet të miratuara nga MASH, por procedurat e vlerësimit do t'iu përshtaten rrethanave të krijuara sipas skenarit aktual, mësimdhënësit duhet të rimendojnë strategjinë e tyre të vlerësimit. Detajet e vlerësimit të nxënësve sipas skenarit të mësimin në shkollë, pasqyrohen në kapitullin 2 të këtij udhëzuesi (pjesën 2.1).

Mësimi i kombinuar - i pjesshëm në shkollë duke u plotësuar me mësimin online – Ky lloj i mësimin do të realizohet kur niveli i rrezikshmërisë për infeksione me COVID-19 është mesatar. **Mësimi do të organizohet me orar të shkurtuar në shkollë dhe do të plotësohet me mësim**

1 Ministria e Arsimit dhe Shkencës “Udhëzuesi i përgjithshëm – Për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020/21 në kushtet e pandemisë COVID 19

2 Ministria e Arsimit dhe Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit “Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë” Prill 2020

online, i kombinuar – prezent në shkollë/klasë dhe mësim në distancë. Shkolla në mënyrë të njëjtë planifikon edhe mësimin për nxënës me nevoja të veçanta dhe për të rritur. Për këtë formë të mësimin sugjerohet që vlerësimi të realizohet në shkollë duke respektuar udhëzimet e paraqitura në këtë dokument. Mësimdhënësit duhet ta bëjnë vlerësimin pjesë e planifikimeve të tyre duke pasur parasysh që nxënësit paraprakisht t'i informojnë për kriteret e vlerësimit, të jenë bashkëpunues me ta duke identifikuar ngecjet, duke këshilluar për nevojat e tyre në procesin e të nxënësve dhe duke udhëzuar se si të arrihet performancë më e lartë. Detajet e vlerësimit të nxënësve sipas skenarit të mësimin të kombinuar (në shkollë dhe në distancë), pasqyrohen në kapitullin 2 të këtij udhëzuesi (pjesën 2.2)

Mësimi në distancë – kjo formë e mësimin do të realizohet kur rrezikshmëria nga infeksioni COVID-19 është e lartë. Në fakt, mësimi në distancë në kushtet e pandemisë, për klasat 1-9 do të realizohet nëpërmjet transmetimit të mësiminve të regjistruara në televizionin publik (RTK), si dhe përmes kanalit të MASH në Youtube. Ndërsa, në nivel të shkollave të mesme të larta mësimi në distancë zhvillohet në mënyrë të decentralizuar – në nivel shkolle, ku mësimdhënësit janë bartësit kryesor të mësimin në distancë. Vlerësimi do të bëhet duke bërë përgatitjen e materialeve elektronike për mësim, kontrollimin e detyrave të nxënësve, dhënien e informatës kthyesë, komunikimin me familjen, etj. Edhe te kjo formë e mësimdhënies dhe të nxënësve vlerësimi duhet të jetë pjesë e planifikimeve të mësimdhënësve, duke pasur për bazë kriteret e vlerësimeve të paraqitura në dokumentat zyrtare të MASH. Detajet e vlerësimit të nxënësve sipas skenarit të mësimin në distancë, pasqyrohen në kapitullin 2 të këtij udhëzuesi (pjesën 2.3).

Realizimi i procesit mësimor në kohë pandemie COVID-19, është një periudhë e ngarkuar për mësimdhënësit, por për nxënësit që në fund të një viti shkollor marrin një dëftesë/ certifikatë/ diplomë, i cili është një moment i rëndësishëm në jetën e tyre. Me këtë qartësohet se vlerësimet do të ndikojnë në vendimet për notat, përparimin, kalimin në një klasë apo nivel tjetër të shkollimit dhe mundësitë e punësimit, prandaj duhet të përdoren mënyra të ndryshme të vlerësimit, të shikohen mirë avantazhet dhe disavantazhet e realizimit të mësimin, si dhe procedurat e realizimit të vlerësimit.

Në bazë të orientimeve të dhëna më lartë, është përgatitur ky udhëzues, qëllimi i të cilit është të ofrojë udhëzime për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në kushtet e pandemisë COVID-19, në mënyrë që të mbështesë procesin mësimor, gjegjësisht vlerësimin e nxënësve në vitin i shkollor 2020/21 dhe të evidentohen arritjet individuale të nxënësve. Gjithashtu, ky udhëzues jep sqarime për parimet e vlerësimit të mësimin në rrethanat e krijuara, me llojet e vlerësimit, me kërkesat për përmbushjen e standardeve dhe me shmangien e pabarazisë për shkak të pamundësisë për të përdorur teknologjinë, si dhe të shkallës së aftësisë digjitale të nxënësve dhe mësimdhënësve.

MASH, ka parasysh gjithë kompleksitetin e situatës së tanishme në Kosovë, e cila nuk dallon shumë nga vendet e tjera të rajonit, si dhe diversitetin e konteksteve në të cilat zhvillohet mësimi në këtë kohë. Për këtë arsye, Udhëzuesi nuk ofron zgjidhje të gatshme për vlerësimin e nxënësve në kushtet e tanishme, por paraqet udhërrëfyes dhe ide për veprim, të cilat shkollat dhe mësimdhënësit duhet t'i zbatojnë duke iu përshtatur kontekstit dhe rrethanave.

1 PARIMET E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE, NË KUSHTET E PANDEMISË COVID 19

Në kontekstin aktual, kur organizimi i mësimi për vitin shkollor 2020/2021, sipas udhëzuesit të përgjithshëm të hartuar nga MASH, planifikohet të realizohet nëpërmjet tre skenarëve³ A, B dhe C, me qëllim që të ndihmohet ruajtja e shëndetit të fëmijëve/nxënësve, mirëqenies shëndetësore të qytetarëve si dhe realizimi i procesit edukativo arsimor sipas kërkesave të kurrikulës, duhet kuptuar se edhe procesi i vlerësimit i nxënësve duhet të realizohet në varësi të skenarëve të mësimi siç u përshkruan edhe në hyrje të këtij udhëzuesi. Prandaj, autoritetet arsimore, ekspertët dhe mësimdhënësit duhet të identifikojnë pikën e bilancit në mes të kërkesave kurrikulare respektivisht arritjes së nivelit të domosdoshëm të rezultateve të nxënësve dhe gjendjes së krijuar. Njëkohësisht kërkohen edhe udhëzime për realizimin e vlerësimit si një pjesë integrale e procesit mësimor duke u mbështetur në parime të përcaktuara në dokumentet kurrikulare që shërbejnë si pikënisje për të siguruar vlerësim të drejtë, objektiv, të vlefshëm, transparent dhe të barabartë/ të paanshëm.

Në kushtet e zhvillimit të mësimi në rrethanat e pandemisë, vlerësimi i nxënësve do të mbështetet në këto parime:

PARIMI 1 **Mirëqenia e fëmijëve/nxënësve** (shëndeti mendor dhe përkrahja psikosociale)

Ky parim buron nga udhëzuesi i përgjithshëm për organizimin e mësimi për vitin shkollor 2020/2021 në kushte të pandemisë COVID19 në Republikën e Kosovës. Referuar këtij parimi, puna e mësimdhënëseve edhe gjatë procesit të vlerësimit të nxënësve duhet të përqendrohet në mirëqenien e fëmijëve/nxënësve dhe në mbështetjen e tyre për të nxënë. Referuar udhëzuesit të përgjithshëm, nëse edukatorët/mësimdhënësit janë mbështetës, të durueshëm, inkurajues, pozitivë dhe të vëmendshëm ndaj fëmijëve/nxënësve edhe gjatë vlerësimit të progresit të tyre, atëherë do të shmangen efektet negative psikologjike që mund të shkaktojnë pandemia tek ata.

PARIMI 2 **Vlerësimi formues ka përparësi në raport me vlerësimin përmbledhës**

Vlerësimi formues është vlerësim që ndodhë në gjithë procesin e të nxënësve, është ndërveprues, afatshkurtër, nxit reflektimin aktiv të mësimdhënëseve dhe nxënësve dhe jep informacion për progresin e arritur. Në rastin e vlerësimit formues të përvojave të të nxënësve kjo arrihet duke punuar më shumë dhe më me kujdes gjatë formulimit të kërkesave dhe detyrave që u jepen fëmijëve nga mësimdhënësit. Një strategji e mundshme për këtë qëllim do të ishte duke shmangur vlerësimin e mbamendjes e të kuptuarit të fakteve dhe duke testuar nivelet më të larta të proceseve kognitive (gjykimin, analizën, kreativitetin). Mësimdhënësit e përdorin vlerësimin formues për të krijuar dëshmi sesi nxënësit po përparojnë në të nxënësve e tyre, japin informata kthyesë nxënësve për t'i mbështetur në të nxënësve e tyre dhe modifikojnë mësimdhënien për të qartësuar qëllimet e të nxënësve. Dëshmitë e mbledhura nga vlerësimi formues për punën e fëmijëve/nxënësve, mund të reflektohen në notën e vlerësimit përmbledhës për periudha mësimore, në mënyrë të veçantë nëse mësimi organizohet vetëm sipas skenarit C, në distancë (TV + e-mësimi). Detaje për vlerësimin formues ofrohen edhe në kapitujt 3, 4 dhe 5 të këtij udhëzuesi.

3

Skenarët sipas udhëzuesit të përgjithshëm:

SKENARI A: Mësimi realizohet me prezencë në institucionet parashkollore dhe shkolla me masat parandaluese;

SKENARI B: Rikthim i pjesshëm në institucionet parashkollore dhe shkolla - mësimi i kombinuar, prezencë dhe mësim në distancë;

SKENARI C: Mësimi realizohet në distancë (TV + e-mësimi).

Vlerësimi përmbledhës ka për qëllim sigurimin e informatave, matjen dhe vlerësimin mbi arritjen e rezultateve të nxënësve të lëndës në mbarim të temave dhe nëntemave mësimore të një periudhe mësimore, përkatësisht vlerësimin me notë në fund të periudhave mësimore dhe në fund të vitit shkollor. Ky lloj vlerësimi, në radhë të parë duhet të marrë parasysh informatat e mbledhura, dëshmitë e vlerësimit gjatë periudhës së zhvillimit të mësimin në objekte shkollore sipas skenarëve A dhe B, përkatësisht matjet dhe vlerësimet e bëra në shkollë. Bazuar në kërkesat e vlerësimit përmbledhës, tani në rrethanat e organizimit të mësimin në kushtet e pandemisë, mësimdhënësit duhet të përdorin lloje të ndryshme të metodave dhe të instrumenteve të vlerësimit, të gjykojnë me kujdes për arritjet e nxënësve, të marrin në konsideratë angazhimin e nxënësve gjatë gjithë periudhës mësimore për të cilën bëhet vlerësimi, në varësi të skenarëve të mësimin, si dhe të kenë në konsideratë të vazhdueshme mirëqenien e fëmijëve/nxënësve.

Mësimdhënësit duhet të jenë të kujdesshëm që në përputhje me realizimin e përmbajtjeve lëndore përmes përdorimit të metodave dhe teknikave të ndryshme të mësimdhënies, në funksion të arritjes së rezultateve të nxënësve, të vlerësojnë shkallën e zotërimit të kompetencave dhe nivelin e arritjes së rezultateve të nxënësve. Detaje për vlerësimin përmbledhës ofrohen edhe në kapitujt 3, 4 dhe 5 të këtij udhëzuesi.

PARIMI 3 Sjellja etike

Një aspekt që fiton rëndësi gjatë mësimin në kushtet e pandemisë, sipas tre skenarëve të përcaktuar, është edhe sjellja etike. Këtu përfshihet sjellja etike e mësimdhënësit gjatë përdorimit të metodave, formave dhe instrumenteve të vlerësimit, shfrytëzimit të rezultateve të vlerësimit për mbështetjen e të nxënësve të nxënësve, përdorimit të platformave të ndryshme të komunikimit online dhe të vlerësimit online, duke shmangur përmbajtje, mesazhe dhe simbole që nuk përkojnë me misionin dhe detyrën e mësimdhënësit/es. Njëkohësisht, mësimdhënësit duhet të jenë të vëmendshëm që me format e aplikuar të vlerësimit të ndikojnë në minimizimin e rasteve të kopjimit, mashtrimit dhe të bashkëpunimit të palejueshëm në mes të nxënësve gjatë vlerësimit, pavarësisht skenarit të zhvillimit të procesit mësimor. Për tejkalimin e situatave të tilla, ndihmon shumë përqendrimi në vlerësimin e proceseve më të larta mendore (si gjykim, analiza, vlerësim, kreativiteti e të tjera).

Mësimdhënësit duhet të kenë qasje të barabartë ndaj të gjithë nxënësve, të mos përdorin asnjë formë të trajtimit të veçantë dhe as paragjyqese gjatë mësimin dhe vlerësimit të arritjeve, në cilindo skenar të realizimit të mësimin. Qasja afirmative mund të përdoret për nxënës të merituar dhe për ata që kanë vështirësi në të nxënë, gjithnjë duke marrë për bazë kërkesat e kurrikulës dhe nivelin e rezultateve të nxënësve që duhet të arrihen sipas planifikimeve mësimore për këtë vit shkollor.

PARIMI 4 Mbështetja në normat ligjore

Mbështetja në normat ligjore që i referohen vlerësimit formues/formativ dhe vlerësimit përmbledhës, duhet të jenë pikënisje në vlerësimin e nxënësve në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID 19, si në informimin e nxënësve për modalitetet e vlerësimit, qëllimet e vlerësimit, kriteret e qarta të vlerësimit, sigurimin e dëshmive të vlerësimit, ashtu edhe në zbatimin e tyre gjatë procesit të vlerësimit. Në varësi të skenarëve të realizimit të mësimin, MASH, sipas nevojës do të sjellë akte nënligjore apo vendime të veçanta, që përcaktojnë masa

dhe kriteret e cilat mundësojnë qasje të barabartë në vlerësimin e nxënësve në përputhje me zhvillimin e mësimin në rrethana dhe kushtet e pandemisë COVID- 19.

PARIMI 5 Kujdesi për kategoritë e cënueshme

Gjatë zhvillimit të mësimin në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID 19, kujdes i veçantë do t'u kushtohet edhe përkrahjes dhe identifikimit të mënyrave kreative të formave për vlerësimin e punës së nxënësve nga kategoritë e cënueshme, përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta, për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, si dhe fëmijët që jetojnë në kushte të vështira ekonomike, për fëmijët që kanë mungesë të qasjes në teknologjinë e nevojshme për të mësuar sipas skenarëve B dhe C (p.sh., internet të shpejtë ose kompjuter në shtëpi). Mësimdhënësit duhet të jetë fleksibël dhe të përdorin forma të përshtatshme të vlerësimit për kategoritë e cënueshme.

2 VLERËSIMI I NXËNËSVE SIPAS KËRKESAVE TË KURRIKULËS DHE SKENARËVE TË ORGANIZIMIT TË VITIT SHKOLLOR 2020/2021, NË KUSHTET E PANDEMISË COVID 19

Aspekte të përgjithshme për vlerësimin e nxënësve sipas kërkesave kurrikulare dhe skenarëve të organizimit të mësimin

Vlerësimi, si një ndër çështjet më komplekse në procesin arsimor, duhet të shërbejë në përkrahjen dhe forcimin e të nxënësve, kontrollin e progresit individual të nxënësve, përmbushjen me sukses të rezultateve të të nxënësve dhe kompetencave të përcaktuara në kurrikulë edhe në këtë sfidë të re që është krijuar nga pandemia në vendin tonë. Në rrethanat e krijuara nga Pandemia COVID-19, nga mësimdhënësit rekomandohet të vlerësohet ajo çka është thelbësore si: rezultatet themelore të lëndës, detyrat, angazhimet si dhe veprimtaritë praktike të cilat ndërlidhen me llojin e mësimin, që zhvillohet nga mësimdhënësit në orën e mësimin sipas skenarëve A,B,C. Për nxënës është me rëndësi ruajtja e mirëqenies shëndetësore dhe mendore, por edhe nxitja për të mësuar dhe zhvilluar shkathhtësitë.

Me Kornizën e Kurrikulës përcaktohen qëllimet, parimet dhe llojet e vlerësimit që sigurojnë ndërlidhjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit të vlerësimit. Sistemi i vlerësimit definon se *çka* vlerësohet, *kur* vlerësohet, *si* dhe nga *kush* realizohen llojet e ndryshme të vlerësimit të nxënësve.

Gjatë procesit të vlerësimit në situatën e krijuar sugjerohet që mësimdhënësit të përdorin forma dhe instrumente të ndryshme më të përshtatshme për vlerësimin e arritjes së nxënësve në kushte të mësimin sipas tre skenarëve të dhënë. Vlerësimi i nxënësve duhet të jetë motivues dhe objektiv, gjithmonë duke pasur parasysh specifikat e moshës, kapacitetet e tyre intelektuale dhe mundësitë e realizimit të tyre në kushte dhe rrethanat aktuale. Kështu, zbatimi i vlerësimit përmes vëzhgimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve dhe mbajtja e evidencës për qëllime dokumentimi dhe planifikimi i punës së mëtutjeshme me nxënësit është i domosdoshëm.

Për të gjitha llojet e vlerësimeve që duhet t'u bëhen nxënësve, pikë referimi duhet të jenë rezultatet për kompetenca në nivel shkollor/ rezultatet e të nxënësve të fushave lëndore/ dhe RNLT në përputhje me frymën e KKK-së dhe Kurrikulës Bërthamë. Për fushat e caktuara lëndore nga mësimdhënësit duhet të përdoren burime të ndryshme mësimore (tekstet shkollore, fletoret e punës, atlaset, enciklopedi, fjalorë të ndryshëm, literaturë e caktuar, softuerë arsimorë, etj.) që motivojnë nxënësit në arritjen e progresit të përvetësimit të njohurive, shprehjeve dhe shkathhtësive të tyre. Është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në shfrytëzimin e burimeve të teknologjisë informative.

Mbi bazën e këtyre informacioneve duhet që nga mësimdhënësit të planifikohen veprime në përkrahje të nxënësve për zotërim të kompetencave dhe të procesit të vlerësimit edhe në këto kushte dhe rrethana.

Në këtë kontekst mundësohet realizimi i qëllimit kryesor të vlerësimit, të përcaktuar në KK - **Mbështetja e të nxënësve të nxënësve**. Mësimdhënësit duhet të promovojnë të nxënësve dhe pjesëmarrjen aktive të të gjithë nxënësve në procesin mësimor si të atyre me nevojat të veçanta, nxënësve me talent dhe me vështirësi në të nxënë me metoda dhe teknika të ndryshme të vlerësimit të përzgjedhura dhe të përshtatshme nga vetë mësimdhënësit që janë të realizueshme

për një klasë të rregullt (fizike) /virtuale. Po ashtu, mësimdhënësit duhet të bëjnë planifikimin e vlerësimit gjithmonë për të nxitur inkurajimin dhe motivimin e nxënësve për të zhvilluar progresin e tyre në vazhdimësi. Duhet të bëhet përfshirja aktive e nxënësve për të ngjallur tek ta dëshirën për nxënie, komunikim dhe për të qenë në gjendje për të vetëvlerësuar rezultatet e tyre të të nxënësve dhe në kushte të mësimin në klasë dhe atë virtual. Realizimi i mundësive të lartpërmendura së bashku me vijueshmërinë dhe angazhimin e nxënësve do të siguronte nivelin e arritjeve të nxënësve dhe njëkohësisht dhe vlerësimin si element kyç në procesin mësimor.

Gjithashtu, mësimdhënësit nxënësve në të gjitha nivelet duhet ofruar më shumë mbështetje dhe përkrahje prandaj kur të realizohet vlerësimi formativ (për nxënie), theks të veçantë duhet kushtuar përmirësimit dhe progresit të arritjeve të tyre. Për ta arritur këtë, duhet të monitorohet puna dhe angazhimi i nxënësve, inkurajimi, aktiviteti dhe duhet forcuar bashkëpunimin e ndërsjellë mësimdhënëses/nxënës. Është e rëndësishme që gjithmonë të sigurohet një qasje e ekuilibruar në caktimin e përmbajtjeve thelbësore që mbështesin drejtpërdrejtë arritjen e rezultateve arsimore të kurrikulave lëndore gjithmonë duke marrë parasysh rrethanat e krijuara. Gjithmonë duhet vlerësuar aktiviteti dhe puna e nxënësve, duhet të vlerësohet pozitivisht përfshirja e tyre në diskutime në mjedisin e klasës si dhe në atë virtual, përmes vlerësimit të bashkëmoshatarëve të tyre dhe vetëvlerësimit të tyre. Detyrat e shtëpisë gjithashtu duhet të vlerësohen për sa i përket cilësisë dhe rregullsisë së tyre. Aktiviteti dhe puna e pavarur e nxënësve duhet të vlerësohen pozitivisht, duke filluar nga detyrat e shtëpisë përmes mësimin bashkëpunues e deri te hulumtimi i pavarur. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, sipas nivelit të përgatitjes dhe formimit të nxënësve etj. Metodot, teknikat dhe format e punës me nxënës duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore, të njohurive, shprehjeve, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të tjera për të përballur këtë sfidë.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës. Vlerësimi i nxënësve në këtë nivel mund të bëhet me lloje dhe metoda të ndryshme të vlerësimit (diskutime, debate, ese), vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte, vlerësimi i portfolios, vlerësimi individual dhe grupor, vlerësimi i detyrave të shtëpisë. Mësimdhënësi, varësisht nga specifikat e tyre, hulumton gjetjen e formave më të përshtatshme për vlerësimin e arritjes së tyre dhe duhet të përgatisin instrumentet e vlerësimit që duhet të bëhen në mbështetje të kriterëve të vlerësimit. Si burim i informacionit përveç tekstit shkollor është e domosdoshme të përdoren edhe burime të tjera si CD (filma, dokumentarë, video eksperimente etj.), interneti (materiale tekstuale, fotografi, programe interaktive, video etj.), enciklopedi, atlase etj. Mësimdhënësi është i lirë të zgjedhë metodologjinë e punës duke vlerësuar drejt kushtet, rrethanat dhe mundësitë të cilat i ka në dispozicion, por gjithmonë duke u bazuar në udhëzimet e KK-së, mësimin e bazuar në arritjen e kompetencave, mësimin me nxënës në qendër, gjithëpërfshirjen, mësimin e diferencuar dhe duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënësve. Përmes shumë informacioneve rreth metodave dhe formave të vlerësimit, referojuni kapitujve 4 dhe 5 të këtij udhëzuesi.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është mbështetja e të nxënësve të nxënësve. Përmes sistemit të vlerësimit të nxënësve të përcaktuar me KKK, kërkohet të sigurohen informacione të vazhdueshme për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve, përshtatshmërinë e kurrikulës dhe përmirësimin e shkollës. Mbi bazën e këtyre informacioneve merren vendime dhe planifikohen veprime në përkrahje të nxënësve për zotërim të kompetencave dhe përmirësim e avancim të procesit të vlerësimit në përgjithësi. Vlerësimi i nxënësve bazohet në rezultatet e të nxënësve për kompetenca, fushë kurrikulare dhe lëndë mësimore, pra në programet e reja mësimore. Gjatë vlerësimit edhe në kushte pandemie mësimdhënësit, krahas parimeve të këtij udhëzuesi, duhet t'ju referohen edhe primeve kryesore të vlerësimit të përcaktuara me dokumentin e kornizës

kurrikulare, si :

Vlefshmëria - Vlerësimi duhet të sigurojë se kërkesat dhe kriteret e vlerësimit të jenë të lidhura me rezultatet e të nxënës për klasën dhe shkallën e kurrikulës, të përdoren matje dhe burime të shumta për të dhënë gjykimet dhe se vlerësimi mbulon shtrirjen dhe thellësinë e programit mësimor.

Transparenca - Vlerësimi duhet të sigurojë se kriteret, metodat dhe procedurat e vlerësimit janë të njohura për nxënës dhe për të gjithë akterët e përfshirë në procesin e vlerësimit edhe në kushte pandemie COVID 2019. Informacioni për nxënësin, lidhur me rezultatet e arritura, informatat kthyesë dhe mundësitë e përparimit të jetë i qartë, i saktë dhe të jepet me kohë.

Besueshmëria - Vlerësimi duhet të sigurojë se gjykimet për përparimin e nxënës bazohen në instrumente, lloje të ndryshme të vlerësimit dhe burime të ndryshme të informacionit. Në këtë proces ofrohen dëshmi për të argumentuar cilësinë e vlerësimit dhe për t'u siguruar se nëse përsëritet vlerësimi atëherë rezultatet do të jenë të njëjta.

Paanshmëria - Vlerësimi duhet të sigurojë se respektohen kërkesat e kodit etik të vlerësimit, respektohen procedurat e vlerësimit ndaj çdo nxënësi apo grupi të nxënësve, përdoren instrumente të ndryshme të vlerësimit që i mundësojnë secilit nxënës të shfaqë performancën e tij/saj dhe ofrohet mbështetja e duhur në të nxënësve dhe nxënësve drejt zotërimit të kompetencave.

Në kushte pandemie COVID 2019 për skenarin A, mësimdhënësit, vlerësimin e nxënësve duhet ta bëjnë në mënyrë të zakonshme, duke pasur kujdes në mirëqenien e nxënësve dhe vështirësitë në nxënie. Mësimdhënësit duhet t'i reduktojnë detyrat, dhe përqendrimi të jetë te arritja e rezultateve bazë të lëndës sipas programit mësimor. Detajet e vlerësimit të nxënësve sipas skenarit A / mësimin në shkollë, pasqyrohen në pjesën 2.1 të këtij kapitulli.

Për skenarin B dhe C mësimdhënësit, vlerësimin e nxënësve duhet ta organizojnë në shkollë, për aq kohë sa është e mundur, por edhe duhet ta orientojnë drejt platformave digjitale, duke pasur kujdes më shumë në mirëqenien e nxënësve dhe vështirësitë që kanë në të nxënë. Detyrat duhet të reduktohen, dhe përqendrimi të jetë te arritja e rezultateve themelore të lëndës. Sugjerohet përdorimi i një platforme unike për komunikim online me nxënës/prindërit dhe dorëzimin e detyrave. Detajet e vlerësimit të nxënësve sipas skenarit B / mësimin të kombinuar / në shkollë dhe mësimin në distancë/ dhe sipas skenarit C/ mësimin në distancë, pasqyrohen në pjesët 2.2 dhe 2.3. të këtij kapitulli.

Referuar parimeve të vlerësimit të nxënësve në kushtet e pandemisë COVID 19, rekomandohet që vlerësimi përmblendës në nivelin e parë të realizohet sipas përcaktimeve të Udhëzimit administrativ 08/2016 për vlerësimin e nxënësve. Ndërsa në nivelet e arsimit II dhe III, rekomandohet që vlerësimi përmblendës të realizohet i integruar, pa pasur nevojë për ndarje në VP1 dhe VP2 siç është paraparë me UA për vlerësimin e nxënësve.

2.1 Vlerësimi i nxënësve sipas skenarit A të organizimit të mësimin

Sipas skenarit A për organizimin e vitit shkollor 2020/2021, në kushtet e pandemisë Covid 19, mësimi mbahet në mënyrë të zakonshme, duke praktikuar vazhdimisht mbajtjen e higjienës personale dhe pastërtisë së ambientit të klasës dhe shkollës. Ashtu si procesi i mësimin, edhe vlerësimi i nxënësve do të realizohet në mënyrë të zakonshme dhe duke iu referuar dokumentit të Kornizës Kurrikulare (2016), kurrikulave bërthamë, kurrikulave lëndore dhe kërkesave kryesore të Udhëzimit administrativ 08/2016 për vlerësimin e nxënësve. Kujdes

të shtuar duhet pasur për mirëqenien e fëmijëve/nxënësve (shëndeti mendor dhe përkrahje psikosociale) dhe vështirësitë e tyre në nxënie.

Në dy javët e para të vitit shkollor 2020-2021, procesi i mësimdhënies duhet përqendruar më së shumti në përsëritjen e njohurive dhe të aftësive të mësuara gjatë mësimin në distancë në vitin shkollor 2019-2020. Mësimdhënësit nëpërmjet formave interaktive të komunikimit dhe verifikimit të informacioneve/përvojave të mësimin, duhet të nxjerrin në pah dhe të identifikojnë humbjet e nxënësve në mësim si dhe të planifikojnë forma të mbështetjes për përkrahjen e nxënësve në zvogëlimin e humbjeve mësimore, duke i ndërlidhur ato me planifikimet shpesh për realizimin e programit mësimor për këtë vit. Format e punës që planifikohen dhe zbatohen nga mësimdhënësit duhet t'i mbajnë nxënësit të angazhuar dhe të fokusuar drejt arritjeve së rezultateve të nxënit.

Në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19, vlerësimi i nxënësve, referuar organizimit të mësimin të realizuar sipas skenarit A, rekomandohet të përqendrohet në:

- ***çështjet thelbësore për përmbajtjet mësimore të programit mësimor të realizuar në shkollë/klasë;***
- ***detyrat, angazhimet, veprimtaritë praktike dhe rezultatet e të nxënit që janë në fokus të planifikimit mësimor për periudhën përkatëse mësimore dhe që ndërlidhen me qasjet në mësimdhënie që aplikohen gjatë mësimin sipas skenarit A.***

Dy llojet kryesore të vlerësimit të nxënësve të përcaktuara me Udhëzimin administrativ 08/2016 për vlerësimin e nxënësve, duhet të zbatohen nga mësimdhënësi/ja e klasës/ lëndës mësimore përkatëse brenda këtij viti shkollor, i cili realizohet sipas skenarit A: a) vlerësimi i vazhdueshëm (vlerësimi formues/formativ dhe vlerësimi përmbledhës) dhe b) vlerësimi përfundimtar.

Vlerësimi i vazhdueshëm (vlerësimi formues dhe vlerësimi përmbledhës)

Në kushtet e realizimit të mësimin sipas skenarit A për vitin shkollor 2020/2021, vlerësimi formues/vlerësimi për nxënie rekomandohet të fokusohet më shumë në ofrimin e informatave kthyes me qëllim të përmirësimit të nxënit dhe në motivimin e nxënësve/ve për nxënie të mtejshme. Metodatat dhe teknikat e vlerësimit formativ/ vlerësimit për të nxënë në rrethanat e organizimit të mësimin sipas Skenarit A, mund të dallojnë nga klasa në klasë, nga lënda në lëndë, në varësi nga qasja e mësimdhënies që ofrohet, numri i grupeve të nxënësve për një klasë dhe mundësitë teknike që mësimdhënësit dhe nxënësit i kanë. Ato mund të jenë: ushtrime kontrolluese, ese, detyra hulumtuese, debate, teste të njohurive, projekte, portfolio e nxënësve, (fizike, elektronike), etj. Informata kthyes për nxënësin/it duhet të praktikohen me gojë dhe/apo me shkrim. Ato, duhet të jenë pozitive, nxitëse, sqaruese, korrigjuese, zhvilluese dhe vlerësuese.

Mësimdhënësit iu rekomandohet që në ditarin e tyre personal për vlerësimin e nxënësve, të mbajnë evidencë për vlerësimet, informatat kthyes të dhëna për nxënësin dhe përparimin e tyre në mësim. Evidencat duhet të mbahen me kujdes, për shkak të rrezikut për të kaluar në skenarët B ose C dhe kërkesave për ta dëshmuar procesin e vlerësimit.

Metodat dhe teknikat e vlerësimit përmbledhës mund të jenë të njëjta, si ato që përdoren për vlerësim formues/formativ, me dallim në qëllime dhe në kërkesa e kritere të vlerësimit përmbledhës.

Në kushtet e organizimit të mësimin sipas skenarit A, rekomandohet që:

- vlerësimi formues të këtë përparësi në raport me vlerësimin përmbledhës;
- të mos përdoren shumë metoda dhe teknika/instrumente të vlerësimit përmbledhës për një lëndë mësimore, gjithnjë duke pasur në kujdes evitimin e ngarkesës për nxënës. Nuk është e detyrueshme që në çdo lëndë të organizohet test me qëllim të vlerësimit përmbledhës, vlerësimi mund të bëhet edhe me detyra përmbledhëse dhe projekte;
- të evitohet mbingarkesa me pyetje/ kërkesa dhe detyra vlerësuese. Përqendrimi të jetë tek arritja e rezultateve bazë të nxënës, të përcaktuara me planifikimet mësimore për periudhën mësimore përkatëse, për të cilat nuk janë bërë matje përmes instrumenteve të vlerësimit të përdorura paraprakisht apo ka mungesë të dëshmive për nivelin e arritjes së rezultateve të nxënës.
- të sigurohen kritere të njëjta të vlerësimit, pavarësisht grupeve të nxënësve të një klase me të cilët punon një mësuesdhënë.

Vlerësimi përfundimtar në fund të vitit mësimor/ shkollor

Realizimi i plotë i mësimit sipas skenarit A, për organizimin e vitit shkollor 2020/2021, në kushtet e pandemisë Covid 19, nënkupton që edhe vlerësimi përfundimtar i nxënësve në fund të vitit mësimor/ shkollor, do të bëhet sipas procedurave të parapara me UA 08/2016 për vlerësimin e nxënësve për këtë lloj të vlerësimit. Kalimet eventuale në skenarë të tjerë të organizimit të mësimit, ndikojnë që vlerësimi përfundimtar të bëhet sipas udhëzimeve për skenarin përkatës.

Vlerësimi për shkallë kurrikulare

Ashtu siç është përshkruar për vlerësimin përfundimtar të nxënësve në fund të vitit shkollor, edhe për vlerësimin për shkallë kurrikulare, do të respektohen procedurat e parapara me UA 08/2016 për vlerësimin e nxënësve për këtë lloj të vlerësimit. Pra, nëse mësimi realizohet sipas skenarit A për organizimin e vitit shkollor 2020/2021, në kushtet e pandemisë Covid 19, vlerësimi për shkallë kurrikulare në këtë vit planifikohet dhe realizohet në nivel shkolle, në frymën e kërkesave kurrikulare dhe me fokus të veçantë në vlerësimin e humbjeve mësimore, si një bazë për të planifikuar mbështetjen e të nxënësve të nxënësve në programet shtesë dhe në vitin shkollor vijues. Kalimet eventuale në skenarë të tjerë të organizimit të mësimit, ndikojnë që vlerësimi për shkallë kurrikulare të bëhet sipas udhëzimeve për skenarin përkatës apo vendimeve të veçanta që ndërkohë mund të sjellë MASH.

2.2 Vlerësimi i nxënësve sipas skenarit B të organizimit të mësimit

Për mësimin sipas skenarit B që do të organizohet pjesërisht në shkollë me orar të shkurtuar, i cili do të plotësohet me mësimin online, vlerësimi formues/ për të nxënë mund të bëhet online, ndërsa vlerësimi përmbledhës i të nxënës duhet të organizohet në shkollë. Sipas këtij skenari,

mësimdhënësit duhet të ndërtojnë strategjitë e vlerësimit bazuar në rezultatet e të nxënës (K.B.) dhe në rezultatet e temave në programet shkollore. Prandaj, duhet të vendosen vlerësime që dëshmojnë angazhimin e nxënësve për temat e caktuara të cilat janë të planifikuara sipas kërkesave të kurrikulit/ kurrikulave bërthamë/ programeve mësimore, por duhet bërë kujdes që të mos shtohet barra teknike, organizative ose zbatuese që mund të ndikojë në performancën e nxënësve. Performanca e nxënësve, notat dhe klasifikimi i shkallës përfundimtare varen nga vlerësimi, prandaj është e detyrueshme të vendosen vlerësime të drejta në përputhje me rezultatet e të nxënës.

Vlerësimi i nxënësve për këtë skenar duhet të jetë pjesë e planifikimit të mësimdhënësit, duke mos i shmangë asnjëherë parimet, kriteret, format, metodat, e vlerësimit të bazuara në kurrikulin/ kurrikulat bërthamë / programet mësimore. Komunikimi për çdo vendim vlerësimi që marrin mësimdhënësit duhet të jetë pjesë integrale e procesit të mësimdhënies duke marrë parasysh rrethanat në të cilat do të punojnë nxënësit, edhe nëse vendosin një vlerësim për atë që kanë planifikuar, paraprakisht nxënësit duhet të informohen për objektivat e atij vlerësimi. Mësimdhënësit do të përdorin detyra, teste portofolio, projekte, ese etj. si mjet për të vlerësuar përparimin e nxënësve në të gjitha kërkesat e planifikuara gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke përpiluar shembuj individual të punës me nxënësit për të dëshmuar performancën e tyre.

Vlerësimi i vazhdueshëm (vlerësimi formues dhe vlerësimi përmbledhës)

Vlerësimi formues/ vlerësimi për të nxënë, sipas realizimit të mësimin në skenarin B, për vitin shkollor 2020/2021, rekomandohet të realizohet për rezultatet e temave dhe nëntemave të planifikuara, për të përcaktuar nivelet e aftësive të nxënësve, ky vlerësim mund të ndihmojë mësimdhënësit në marrjen e vendimeve nëse nxënësit kanë nevojë për mësim mbështetës në tema të caktuara. Paraprakisht në dy javët e para të procesit mësimor mësimdhënësit duhet të bëjnë përsëritje të mësimave të realizuara në kohë pandemie në mënyrë që të krijojnë një pasqyrë më të qartë për arritjet e nxënësve, mbi të cilën do të bëjnë planifikimin e mësimin për vitin shkollor 2020/21. Vlerësimi nga planifikimi i procesit mësimor, mësimdhënësit vlerësimin duhen ta kenë pjesë integrale të punës së tyre. Ky vlerësim do t'i raportohet shkollës, po ashtu raporti përshkruar mbahet në evidencën e mësimdhënësit dhe iu komunikohet nxënësve-prindërve. Raportet duhet të jenë pozitive, nxitëse, sqaruese, korrigjuese, zhvilluese dhe vlerësuese, debate, teste të njohurive, projekte, portofolio e nxënësit, (fizike, elektronike), etj. Informata kthyesë për nxënësin/it duhet të praktikohen më gojë dhe/apo me shkrim.

Pavarësisht situatës dhe rrethanave aktuale të krijuara vlerësimi formativ duhet të jetë i vlefshëm, i saktë (respektimi i afateve kohore), konstruktiv dhe specifik për nevojat e të nxënësve. Elementi i vlefshmërisë së vlerësimit formativ duhet të lidhet me përafrimin e përmbajtjes së njohurive që nxënësit duhet të kenë marrë si pjesë e procesit të të nxënës. Aspekti i saktësisë (respektimi i afateve kohore) i referohet përdorimit të mundshëm të vlerësimit për të ndërmarrë veprime të shpejta dhe me kohë që të sigurohet mbështetje me qëllim të përmirësimit në procesin e të nxënës nëse është e nevojshme. Elementi i konstruktivitetit në këtë lloj të vlerësimit i referohet aftësisë për t'u dhënë nxënësve informata kthyesë në mënyrë që ata të marrin informacione që u ndihmojnë atyre që të identifikojnë paqartësitë dhe pengesat, duke ju dhënë udhëzime se si të përmirësohen dhe të arrijnë qëllimet e procesit të të nxënës. Në fund të fundit, qëllimi specifik i vlerësimit formativ është sigurimi i informimit të mësimdhënësve dhe nxënësve nëse janë arritur qëllimet specifike të të nxënës, dhe çfarë nevojitet në rast se ato nuk janë arritur akoma. Për të arritur dhe mbështetur vlerësimin formativ në kontekstin e rrethanave të krijuara me COVID-19 në përputhje me këto elemente mësimdhënësit duhet munduar që të sigurojnë burime dhe mjete në përputhje me këto elemente madje edhe në kushte të tilla sipas skenarit B. Këto burime mund të jenë p.sh. Shembuj të aplikacioneve të ndryshme të programeve apo qasjes online duke u mundësuar mësimdhënësve që të kryejnë aktivitetet e synuara dhe qëllimet e tyre.

Në rrethanat ku mësimi zhvillohet në objektet shkollore por edhe te grupi i nxënësve që për arsye të caktuara nuk kanë mundësi të mënyrës së qasjes online, mund të përgatiten materiale të shtypura në formë fizike për të mbështetur dhe forcuar njohuritë e nxënësve.

Edhe pse me këtë skenar të mësimi aktualisht nuk është e mundur që të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit të jenë bashkërisht si klasë në të njëjtën hapësirë (për shkak të ndarjes së nxënësve brenda klasës) është e domosdoshme që procesi i mësimdhënies dhe nxënies të vazhdojë në mënyrë të atillë që të shmanget humbja e mësimi. Vlerësimi formativ mund t'ju ndihmojë të gjithë nxënësve duke u siguruar atyre, mësimdhënësve dhe prindërve informacionin e nevojshëm për të mbështetur procesin e të mësuarit, megjithëse është edhe nga distanca.

Udhëzimet për vlerësimin e vazhdueshëm (vlerësimin formues dhe vlerësimin përmbledhës) të dhëna në pjesën për vlerësimin e nxënësve sipas Skenarit A të organizimit të mësimi, janë të vlefshme edhe për vlerësimin e nxënësve sipas skenarit B për organizimin e mësimi. Ato analizohen nga secili mësimdhënësi dhe në ndërlidhje me organizimin e mësimi sipas skenarit B, zbatohen gjatë vlerësimit të nxënësve dhe dokumentohen me ditar personal të vlerësimit, ditarët e klasës, instrumentet e vlerësimit, raporte për vlerësim, etj.

Vlerësimi përfundimtar në fund të vitit mësimor/ shkollor

Realizimi i mësimi sipas skenarit B, për organizimin e vitit shkollor 2020/2021, në kushtet e pandemisë COVID 19, nënkupton që vlerësimi përfundimtar i nxënësve në fund të vitit mësimor/shkollor, do të bëhet sipas procedurave të parapara me UA 08/2016 për vlerësimin e nxënësve duke iu përshtatur kriteret të parapara në udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimi në kohë pandemie. Për këtë lloj të vlerësimit, nxënësit duhet të informohen saktë për objektivat e vlerësimit të nxjerra nga rezultatet e temave dhe nëntemave mësimore të cilat kanë qenë të përfshira në planifikimet e mësimdhënësve. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve për mësimin sipas këtij skenari duhet të realizohet në ambientet shkollore.

Vlerësimi për shkallë kurrikulare

Ashtu siç është përshkruar për vlerësimin përfundimtar të nxënësve në fund të vitit shkollor, edhe për vlerësimin për shkallë kurrikulare, do të respektohen procedurat për vlerësimin e nxënësve për këtë lloj të vlerësimit, në kushtet e pandemisë COVID 19. Nëse mësimi në pjesën më të madhe të kohës realizohet sipas Skenarit B për organizimin e mësimi, për këtë formë të vlerësimit institucionet përkatëse arsimore do të marrin vendim, varësisht raportet lidhur me organizimin e mësimi dhe nga situata e shkaktuar nga pandemia.

2.3 Vlerësimi i nxënësve sipas skenarit C të organizimit të mësimi

Mësimi në distancë - Mësimi në distancë do të organizohet sipas skenarit C, për klasat 1-9 realizohet nëpërmjet transmetimit të mësimave të regjistruara në televizionin publik (RTK), si dhe përmes kanalit të MASH në Youtube. Ndërsa, në nivel të shkollave të mesme të larta mësimi në distancë, zhvillohet në mënyrë të decentralizuar – në nivel shkolle, ku mësimdhënësit janë bartësit kryesor të mësimi në distancë, duke pasur parasysh udhëzimet dhe kërkesat që bazohen në dokumentet e nxjerra nga MASH për këtë formë të mësimi. Vlerësimi do të bëhet duke bërë përgatitjen e materialeve elektronike për mësim, kontrollimin e detyrave të nxënësve, dhënien e informatës kthyesë, komunikimin me familjen, etj. Në fund të vitit shkollor 2019/20, shkollat

në të gjithë vendin kanë përdorur mjete të ndryshme të vlerësimit. Viti i ri shkollor 2020/21, do të sjellë qartë sfida të reja, ne duhet të mbështetemi edhe më shumë në mjetet tona të vlerësimit dhe t'i zbatojmë ato me një shkallë besnikërie dhe besueshmërie edhe më të lartë.

Gjatë vlerësimit online mësimdhënësi duhet të marrë parasysh se disa nxënës kanë nevojë për rregullimin e mjeteve të teknologjisë (p.sh. pajisjet IT) gjë që do të shtojnë stres dhe ankth të panevojshëm, prandaj këtyre nxënësve duhet t'ju lejohe kohë shtesë. Po ashtu, duhet pasur parasysh se nxënësit nuk mund të riprodhojnë njohuritë e tyre në presionin e kohës, mësimdhënësit duhet të caktojnë detyra konvencionale në shtëpi, provime të bazuara në diskutim ose detyra në formë të eseve ku nxënësit kanë mundësi më të gjatë kohore për të përfunduar detyrën, por duhet të planifikohet koha saktë se sa mund të zgjasë detyra p.sh. një javë. Detyra duhet të përmbajë konceptet, që duhet të kuptohen, për tu zbatuar, të përmbajë analizën e një procesi, të bëhet vlerësimi i tij dhe të krijohet një përfundim i saktë.

Vlerësimi me shkrim me një kohë më të gjatë për përfundim (ese janë shembulli tipik) mund të shoqërohet, në mënyra të ndryshme, me mundësinë e integritit dhe zbatimit të ideve relativisht komplekse. Varësisht nga mundësitë preferohet që procesi i vlerësimit të realizohet në ambientet shkollore.

Vlerësimi i vazhdueshëm (vlerësimi formues dhe vlerësimi përmbledhës)

Në kushtet e realizimit të mësimit sipas skenarit C për vitin shkollor 2020/2021, vlerësimi formues/vlerësimi për nxënie rekomandohet të fokusohet më shumë në ofrimin e informatave kthyesë me qëllim të përmirësimit të të nxënësve dhe në motivimin e nxënësve për nxënie të mëtejshme. Metodatat dhe teknikat e vlerësimit formativ/ vlerësimit për të nxënë në rrethanat e organizimit të mësimit sipas Skenarit C, mund të dallojnë nga klasa në klasë, nga lëndë në lëndë, në varësi nga qasja e mësimdhënies që ofrohet, numri i grupeve të nxënësve për një klasë dhe mundësitë teknike që mësimdhënësit dhe nxënësit i kanë. Ato mund të jenë: ushtrime kontrolluese, ese, detyra hulumtuese, debate online, teste të njohurive, projekte, portfolio e nxënësve, (elektronike), etj. Informata kthyesë për nxënësin/it duhet të praktikohen me shkrim. Ato, duhet të jenë pozitive, nxitëse, sqaruese, korrigjuese, zhvilluese dhe vlerësuese.

Mësimdhënësve iu rekomandohet të mbajnë evidencë në ditarin e tyre personal për informatat kthyesë të dhëna për nxënësit dhe përparimin e tyre në mësim. Evidencat duhet të mbahen me kujdes, për ta dëshmuar procesin e vlerësimit. Mësimdhënësit duhet të raportojnë për performancën e nxënësve duke i vënë në pah arritjet dhe ngecjet e tyre. Raportet duhet t'ua përcjellin shkollës dhe prindërve sipas periodave mësimore të parapara me UA për vlerësim.

Metodat dhe teknikat e vlerësimit përmbledhës mund të jenë të njëjta, si ato që përdoren për vlerësim formues/formativ, me dallim në qëllime dhe në kërkesa të vlerësimit përmbledhës.

Në kushtet e organizimit të mësimit sipas skenarit C, rekomandohet që:

- ***vlerësimi formues të ketë përparësi në raport me vlerësimin përmbledhës;***
- ***të mos përdoren shumë metoda dhe teknika/instrumente të vlerësimit përmbledhës për një lëndë mësimore, gjithnjë duke pasur në kujdes evitimin e ngarkesës për nxënësit. Nuk është e detyrueshme që në çdo lëndë të organizohet test me qëllim të vlerësimit përmbledhës, vlerësimi mund të bëhet edhe me detyra përmbledhëse dhe projekte;***

- *të evitohet mbingarkesa me pyetje/ kërkesa dhe detyra vlerësuese. Përqendrimi të jetë tek arritja e rezultateve bazë e të nxënësve, të përcaktuara me planifikimet mësimore për periudhën mësimore përkatëse, për të cilat nuk janë bërë matje përmes instrumenteve të vlerësimit të përdorura paraprakisht apo ka mungesë të dëshmive për nivelin e arritjes së rezultateve të nxënësve;*
- *të sigurohen kritere të njëjta të vlerësimit, pavarësisht grupeve të nxënësve të një klase me të cilët punon një mësues;*
- *mësuesin duhet të kenë parasysh që nxënësit mund të bëjnë mashtrime në kryerjen e detyrave, prandaj është një shqetësim në lidhje me çdo lloj vlerësimi në distancë, duhet të sqarohet se si dizajni i mirë i vlerësimit mund të ndihmojë në zbutjen e disa prej këtyre problemeve;*
- *Vlerësimi të bëhet me një platformë që siguron besueshmëri të vlerësimit dhe të rezultateve të tij. Në platformën online duhet të përshkruhet një plan vlerësimi për vitin shkollor 2020/2021;*
- *Të gjitha angazhimet të bëhen që vlerësimi përmblendhës, që realizohet për qëllime të vlerësimit me notë për periudha mësimore, të bëhet në shkollë.*

3 METODAT E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE NË KUSHTET E PANDEMISË COVID 19

Në rrethanat e mësimit sipas tre skenarëve A, B dhe C, pritët që mësimmhënësit të zbatojnë disa qasje standarde dhe qasje kreative e ndërvepruese që sigurojnë mbështetjen e të nxënët të nxënësve, i cili është qëllimi kryesor i vlerësimit.

3.1 Metodatat standarde

Metodat standarde të vlerësimit në kushtet e mësimit në shkollë, përfshijnë ato të bazuara në kontrollimin e detyrave, vlerësimin me gojë dhe me shkrim (teste, provime), etj. Prandaj, referuar mundësive dhe përvojës së mësimmhënësve, rekomandohet që këto metoda standarde për vlerësimin e nxënësve të praktikohen edhe në kushtet e organizimit të mësimit në rrethanat e pandemisë, varësisht nga skenarët e organizimit të mësimit. Përdorimi i metodave/ qasjeve standarde të vlerësimit në distancë dhe shpeshësia e tyre, varet nga lënda mësimore (përfshirë edhe fondin javor të orëve mësimore), temat mësimore, njësitë mësimore që zhvillohen gjatë mësimit në distancë dhe veçanërisht nga rezultatet e të nxënësit që duhet të maten dhe të vlerësohen.

Kontrollimi i detyrave. Detyrat shtëpisë në të shumtën e rasteve udhëzohen nga mësimmhënësit që të merren nga librat bazë për nxënës, të dedikuar për punë të pavarur. Por, në raste të tjera, për detyrë shtëpie mund të konsiderohen edhe aktivitetet e tjera, si për shembull, ‘hulumtimet’ në kuadër të realizimit të projekteve, reflektimet e nxënësve apo formulimet e problemeve dhe zgjidhjet e tyre nga vetë nxënësit.

Duke marrë parasysh se në klasat virtuale, jo gjithmonë është e mundur që nxënësit të marrin informata kthyesë për detyrat e kryera, udhëzohet/rekomandohet që për detyrat e shtëpisë të jepen edhe pyetje që i mundësojnë nxënësit të vetë reflektojnë, kurse mësimmhënësit, të informohen më mirë për nevojat e nxënësve për përmirësime eventuale. Këto informata janë shumë të vlefshme që mësimmhënësi mund t’i shfrytëzojë si udhëzime për punën individuale me nxënës. Një shembull që mund të përdoret për pyetjet që lidhen me detyrat e shtëpisë është fleta me tri pyetje (“Reflektimi im”):

- *Cfarë është diçka për të cilën keni ende paqartësi, dyshime ose për të cilën keni pyetje?*
- *Cila ishte ideja kryesore që mësuat sot?*
- *Si mund të shfrytëzoni idetë nga mësimi që zhvilluat sot në jetën e përditshme?*

Reflektimet e tilla i bëjnë nxënësit të vetëdijesohen për rëndësinë që ka kryerja e detyrave në mënyrë të pavarur dhe i bëjnë ata të marrin përgjegjësinë për të nxënët e tyre. Mësimmhënësit duhet të kenë kujdes për vëllimin e detyrave, strukturën dhe përmbajtjen e tyre, në raport me moshën e nxënësve, temën/njësien mësimore dhe rezultatit e të nxënët që mund të shpërfaqet nëpërmjet detyrave dhe hapave të aplikuar për realizimin e tyre. Mësimmhënësit duhet të përdorin kritere të vlerësimit për detyrat që kontrollohen, si dorëzimin me kohë, angazhimin e treguar të nxënësit në detyra, format alternative dhe kreative të kryerjes së detyrave, saktësinë në rezultatet e detyrave dhe në respektimin e hapave dhe procedurave të domosdoshme.

Lidhur me dorëzimin me kohë të detyrave në klasë apo në platformat që i përdorin mësimmhënësit dhe nxënësit (si p.sh. dropbox), mësimmhënësit duhet të vendosin afate që mbasin në suaza të

mobilizimit kreativ dhe që nuk shkaktojnë presion dhe frustrim të tepruar tek nxënësit. Detyrat duhet të jenë sipas një modeli të punës individuale, që mban nxënësin të angazhuar, shmanget kopjimet dhe inkurajon nxënësin për punë të pavarur.

Vlerësimi me shkrim në klasë dhe online. Për përdorimin e metodës së vlerësimeve me shkrim, mësimeve mund të shfrytëzohen pyetësit dhe kuizet si mjet për të përpiluar teste me detyra dhe pyetje me zgjedhje të shumëfishtë, pyetje të hapura, pyetje me plotësim dhe përgjigje të shkurtra. Kërkesat/pyetjet që shtrihen për vlerësimin e nxënësve duhet të sigurojnë standardet minimale për nivelet e vështirësive, veçantitë e klasave dhe nxënësve, përfshirë ato të nxënësve me nevojë të veçanta. Ka mundësi të shumta për ndarjen e materialeve me nxënës dhe bashkëveprimin me ta përmes platformave online që përdorin shkollat. Në disa lëndë si në matematikë, fizikë apo kimi, është e zakonshme të kontrollohen jo vetëm saktësia e përgjigjeve, por edhe procesi i zgjidhjes së detyrave. Në këto raste, mësimeve mund të kërkojnë nga nxënësit të shtojnë një fletë për shpjegimet e zgjidhjeve që mundësohet nga platformat përkatëse ose të fotografojnë zgjidhjet dhe të dërgohen në kohën e caktuar përmes aplikacionit që përdoret për komunikim. Kjo e dyta është e mundur të realizohet edhe në rastet kur ka pengesa për shfrytëzim të pajisjeve dhe platformave të veçanta.

Që të shmangen shqetësimet për integritetin e përgjigjeve, pra nëse nxënësi i ka zgjidhur detyrat në mënyrë të pavarur, mund të jetë ndihmues fakti kur mësimeve kryesisht i njohin nxënësit e tyre paraprakisht dhe nëse e përcjellin vazhdueshëm përparimin e tyre në faza të ndryshme të procesit të të nxënës. Në rast se punojnë me nxënës të ri, monitorimi gjatë vlerësimit të jetë më i theksuar. Pas kontrollimit të testeve mund të organizohet një intervistë/provim me gojë i shkurtër, në mënyrë që mësimeve të sqarojë vështirësitë që janë paraqitur gjatë zgjidhjes së detyrave, dhe se ku duhet përmirësuar në të ardhmen. Kombinimi i vlerësimit me shkrim online me vlerësimin me gojë mund të organizohet edhe në rastet e veçanta kur ka kërkesa nga nxënësit për arritjen e një note më të madhe ose kur është e pamundur që nxënësi të përfshihet në provimin me shkrim. Gjithsesi, në secilin rast duhet të respektohet liria e veprimtari të mësimeve/ës. Mësimeve do të jenë të kujdesshëm të mos ngarkojnë nxënësit me teste të tepërta për të mos krijuar tension e frustrim tek nxënësit.

Vlerësimi me gojë në klasë dhe online. Mënyra më e thjeshtë e vlerësimit me gojë në klasë është përmes drejtimtari të pyetjeve dhe kërkesave të përgatitura paraprakisht, në ndërlidhje me rezultatet e të nxënës që synohet të vlerësohen përmes vlerësimit me gojë. Ndërsa, mënyra më e thjeshtë e vlerësimit me gojë online është përmes video-takimeve virtuale që mund të mbahen drejtpërdrejtë përmes platformave që mësimeve të përdorin lehtësisht me nxënësit e tyre.

Rekomandohet që vlerësimi me gojë të mos realizohet në secilën lëndë mësimore, pasi do të ngarkonte në mënyrë të panevojshme mësimeve dhe nxënësit, si dhe realizimin e mësimit në mënyrë të veçantë skenarët e mësimit B dhe C, referuar qëllimeve të tij. Sidoqoftë, për lëndët mësimore që kanë fond javor të orëve mësimore 4 orë e më shumë, vlerësimi me gojë që ka ndikim në notën e periudhës mësimore, sugjerohet të bëhet një herë brenda një periudhe mësimore, në mënyrë të veçantë nëse mësimeve dhe nxënësi kanë dilema në notën e periudhës mësimore, respektivisht në notën përfundimtare. Për lëndët mësimore, me fond 3 emë pak orë mësimi në javë, rekomandohet që vlerësimi me gojë gjatë organizimit të mësimit sipas skenarëve B dhe C të praktikohet vetëm në rastet kur mësimeve konstatojnë se ka elemente të pamjaftueshme për të përfunduar një vlerësim me notë maksimale, siç është vlerësimi me notë shkëlqyeshëm ose për të verifikuar kërkesat e ndonjë vlerësimi online të organizuar me shkrim.

3.2 Metodatat/teknikat inovatore (kreative dhe ndërvepruese)

Me paradigmen e re të mësimeve që e kërkon Kurrikula e Kosovës, nxënësi duhet të jetë aktiv në të gjitha veprimtaritë që zhvillohen në klasë dhe jashtë saj. Kjo kërkesë duhet të merret

parasysh edhe në tre skenarët e organizimit të mësimi, përfshirë edhe mësimin në klasat virtuale. Përzgjedhja me kujdes e metodave të mësimdhënies duhet të ketë parasysh edhe vlerësimin, si proces i rëndësishëm që “drejton të nxënit”. Prandaj, në mjedisin virtual, ne kemi mundësinë të aplikojmë një numër të madh të metodave inovatore të vlerësimit që janë më të përshtatshme për vlerësimin e niveleve më të larta të proceseve njohëse, por edhe më stimuluese për nxënësit.

Reflektimet për detyrat e shtëpisë, zhvillimi i e-portfoliove, projektet, kuizet, zgjidhja e problemeve, janë disa nga metodat inovatore që janë treguar të suksesshme për t’u zbatuar gjatë procesit të të nxënit. Metodat e tilla konsiderohen si mjete nxitëse dhe motivuese për angazhim më të madh të nxënësve në procesin mësimor. Ato u mundësojnë nxënësve të kontrollojnë të kuptuarit e tyre, të kryejnë detyra të caktuara dhe në të njëjtën kohë të jenë kreativë në zgjidhjen e detyrave dhe problemeve me kontekste më të përgjithshme.

Aktivitetet e tilla janë të përshtatshme të shfrytëzohen nga mësimdhënësit të të gjitha niveleve dhe në çdo skenar të procesit të mësimdhënies, e sidomos janë të përshtatshme të shfrytëzohen nga mësimdhënësit e lëndëve që në rastin e mësimi sipas skenarit C nuk transmetohen në RTK dhe përmes kanalit të MASH-it në Youtube (përfshirë lëndët zgjedhore).

Përdorimi i metodave të shumëllojshme të vlerësimit dhe shpeshtësia e tyre varet nga temat, nëntemat, njësitë mësimore që zhvillohen gjatë mësimi në distancë dhe veçanërisht nga rezultatet që priten të përmbushen nga nxënësit. Por, nuk duhen anashkaluar edhe faktorët e tjerë ekonomikë e socialë. Më poshtë po i prezantojmë disa metoda/teknika inovatore për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimi online.

Portfolio elektronike

Që të vlerësohet saktë e drejt përparimi i nxënësve, një mjet gjithashtu i rëndësishëm është portfolio ose dosja e nxënësit/es. Ajo paraqet një ‘koleksion’ të qëllimshëm të punës së nxënësve dhe tregon për përjekjet, përparimin dhe të arriturat e tij/saj në një lëndë/fushë të caktuar. Disa udhëzime për vlerësimin me portfolio elektronike:

- *Filloni me më pak kërkesa nëse keni numër të madh të nxënësve. Arsyetoni: Cili është qëllimi i mbajtjes së portfolios?*
- *Njoftoni qartë nxënësit dhe prindërit e tyre për kriteret e vlerësimit. Paraqitni shembuj të punës që do të jenë pjesë e portfolios.*
- *Përcaktoni kohën e shqyrtimit të portfoliove dhe dhënies së informatave kthyesë në mënyrë që nxënësit të marrin udhëzime të sakta dhe të përmirësojnë punën e tyre.*
- *Caktoni qartë kriteret e vlerësimit dhe nëse do të vlerësoni vetëm shembujt e përmirësuar apo edhe punën fillestare. A do të kërkonit reflektim me shkrim?*
- *Nëse portfolio do të shfrytëzohet për vlerësim përmblendhës tregoni cilat janë kriteret?*

Pra, portfolio elektronike, pavarësisht skenarëve të organizimit të mësimi, mund të shfrytëzohet jo vetëm për vlerësimin e njohurive të nxënësve, por njëkohësisht edhe për zhvillimin e shkathtësive dhe vlerave pozitive për punë.

Kriteret për informata kthyesë lidhur me vlerësimin e përmbajtjes së portfolios rekomandohet të jenë:

- *Kryerja me rregull e detyrave të shtëpisë: angazhim i vazhdueshëm në kryerjen e të gjitha detyrave me shkrim.*
- *Saktësia e detyrave të shtëpisë: janë dërguar me kohë, kanë qenë të sakta ose*

janë kthyer me sugjerime (sa herë).

- *Cilësia dhe origjinaliteti e kreativiteti i provave, reflektimeve, vetëvlerësimit: sa janë origjinale, mënyra/procedurat e zgjidhjeve, ndikimi në plotësimin e njohurive, shkathtësive dhe shprehive e vlerave të nxënësit.*
- *Struktura e punimeve të pavarura: Aspekti gjuhësor, të shprehurit, logjike e radhitjes, objektiviteti i vetëvlerësimit.*
- *Saktësia dhe kreativiteti i përgjigjeve në pyetjet e bëra lidhur me temat e caktuara.*

Zgjidhja e problemeve

Mësimi në klasë, por edhe mësimi në distancë mundëson të shfrytëzohet të nxënit nëpërmjet zgjidhjes së problemeve i cili paraqet një mjet të fuqishëm që nxitë shumëfish të menduarit kreativ dhe krijues. Krijimi i një mjedisi virtual ku nxënësit hulumtojnë dhe angazhohen në një sërë strategjish për zgjidhjen problemeve i aftëson ata të eksplorojnë alternativat dhe të zhvillojnë vetëbesimin e tyre për të mësuar. Detyra për zgjidhjen e problemit përmban këto elemente:

- a) përcaktim dhe identifikim i problemit;
- b) analizë e problemit;
- c) identifikim i zgjidhjes së mundshme;
- d) përzgjedhje e zgjidhjes më të mirë;
- e) vlerësim i zgjidhjes;
- f) zhvillim i një plani veprimi;
- g) paraqitje e zbatimit.

Problemet mund të jenë të asaj natyre që, për zgjidhjen e tyre nxënësit duhet të hulumtojnë në internet, duke shfrytëzuar edhe shkathtësitë e tyre gjuhësore.

Vlerësimet e shpejta (kuizet)

Kur vlerësohen njohuritë për të kuptuarit e koncepteve apo shkathtësitë për përdorim të saktë të procedurave zakonisht përdoren teste ku pyetjet mund të kenë dy përgjigje (apo alternativa), shumë alternativa, me çiftime apo me plotësime. Por nuk duhet anashkuar edhe testet ku duhet arsyetuar përgjigjet apo kur duhet dhënë shpjegim për procedurën e zgjidhjes. Detyrat e përfshira në teste të tilla duhet të jenë në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit dhe zhvillimit të aftësive të nxënësve për të arsyetuar, argumentuar dhe për të menduar në mënyrë kritike e kreative. Nëpërmjet zgjidhjes së detyrave/problemeve qoftë të atyre që kërkojnë nivel të ulët të njohjes, apo edhe të atyre që kërkojnë të menduar të nivelit të lartë, fokusi duhet të jetë tek arritja e rezultateve të të nxënit.

Për të ndihmuar nxënësit që të jenë të suksesshëm, pas çdo tërësie, është mirë të organizohet një test i shkurtër për të vlerësuar nëse ka mangësi apo keqkuptime në lidhje me njësitë e zhvilluara. Ngjashëm si te testet me shkrim, mund të shfrytëzohen platforma të ndryshme, për të bërë të dukshëm komunikimin midis mësimeve dhe nxënësve.

Kuizet që merren në internet (apo të përgatitura nga mësimeve) ofrojnë informacione që japin informata kthyesë për të bërë modifikime të nevojshme për përmirësimin e të nxënit.

Vlerësimi i bazuar në projekte (VBP)

Përmes vlerësimit të bazuar në projekte (VBP) mësimeve vlerësojnë nxënësit të cilët

duhet të punojnë për një projekt në një periudhë kohe, të kalojnë nëpër një sërë aktiviteteve dhe të dalin me zgjidhje të duhura për problemin e identifikuar.

Vlerësimi i bazuar në projekte është një alternativë ndaj testeve që i mundësojnë nxënësit të angazhohen në mënyra më konkrete. Në vend që thjesht të studiojnë teorinë, një projekt praktik kërkon nga nxënësit të zbatojnë ato që kanë mësuar.

Vlerësimi i bazuar në projekte ndihmon në identifikimin e përparësive për një mësimdhënie të duhur dhe përcakton se çfarë lloj burimesh dhe materialesh do të jenë të dobishme për t'ju siguruar nxënësve gjatë punës së tyre me projekte.

Vlerësimi i bazuar në projekte gjithashtu mundëson përcjelljen e procesit të të nxënës, progresit të nxënësve drejt rezultateve të të nxënës, bashkëpunimit të tyre, përdorimit të teknologjisë dhe rezultateve të tjera.

Vlerësimi i bazuar në projekte bëhet në vazhdimësi që nga fillimi i projektit si në vijim

- ***Që nga momenti kur përcaktohen pritjet dhe fillon projekti***
- ***Gjatë kohës kur nxënësit fillojnë pyetjet dhe jepen ide dhe stuhi mendimesh për projekt***
- ***Gjatë kohës kur grupet zhvillojnë një vizion dhe plan për punën e tyre***
- ***Gjatë punës në projekt.***

Vlerësimi i bazuar në projekte ndihmon mësimdhënësit të identifikojnë nevojat e nxënësve në arritjen e rezultateve të të nxënës, të përcaktojnë se si të përdorin më së miri kohën për të mbështetur të nxënës dhe të parashikojnë më mirë se sa kohë do të nevojitet si dhe të japin informata kthyesve nxënësve dhe identifikojnë mënyra specifike për t'u përmirësuar.

Vlerësimi i bazuar në projekte gjithashtu ndihmon nxënësit të reflektojnë mbi të nxënës dhe ndërlikohen me rezultatet e synuara, të përcaktojnë se ku janë në arritjen e rezultateve të synuara, të identifikojnë idetë që ata mund të hulumtojnë dhe marrin në konsideratë dhe veprimet që mund të bëjnë për të përmbushur qëllimet e tyre.

Vetëvlerësimi

Është metodë e vlerësimit të cilën nxënësit e vlerësojnë procesin e tyre të të nxënës, duke përfshirë përcaktimin e kritereve të performancës dhe vlerësimin e vetes se sa i kanë arritur kriteret e përcaktuara.

Vetëvlerësimi është një element plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësuesi. Nxënësit vlerësojnë punën e tyre dhe më pas mësuesi dhe nxënësit bëjnë komentimin përfundimtar. Reflektimet e nxënësve mund të bëhen me regjistrime audio, video ose punime të shtypura dhe mostra pune. Mësuesi bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arritjet. Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin që ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxënës të tyre.

Kur nxënësi vlerëson njohuritë e veta momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënës, ai/ ajo fiton ide më të qarta se si t'i ndihmojë vetes për t'u përmirësuar. Vetëvlerësimi është i rëndësishëm në mësimin në distance kur nuk mund ta shihni procesin e të nxënës *në veprim*.

Vlerësim i nxënësve për njëri-tjetrit/ vlerësimi i ndërsjellë

Gjatë vlerësimit të njëri-tjetrit, nxënësit vlerësojnë punën e shokëve të klasës, në krahasim me kriteret e vlerësimit, të vendosura nga mësuesi, ose nga nxënësit dhe mësuesi së bashku. Një aspekt i rëndësishëm i vlerësimit të njëri-tjetrit është se, ky lloj vlerësimi i përfshin nxënësit në dialog, duke komentuar dhe diskutuar rreth punës së tyre për të pasuruar vlerësimin e njëri-tjetrit dhe për ta përdorur atë në mënyrë produktive. Kur nxënësit komentojnë punën e shokëve

të tyre, ata përdorin gjuhën joformale, cila është e kuptueshme për ta. Përveç kësaj, nxënësit krahasojnë punën e nxënësve të tjerë me kriteret e vlerësimit, çfarë u mundëson atyre, të dallojnë elementet e pazgjidhura të punës së shokëve, por edhe të punës së tyre njëkohësisht.

Gjatë mësimit online, reagimet e nxënësve mund të kryhen në internet përmes një diskutimi ku nxënësit postojnë punën e tyre, ose përmes një platforme digjitale (p.sh. Skype ose Zoom) ku nxënësit diskutojnë për punën e njëri-tjetrit në kohë reale. Shumë nga nxënësit mund të lidhen përmes mediave sociale, prandaj duhet të nxiten që të ndajnë punën edhe në këto platforma.

Dobitë e këtij vlerësimi janë: ndihmon nxënësit ta kuptojnë më mirë procesin e vlerësimit dhe e shton motivimin e tyre për të nxënë, nxënësit e kuptojnë punën e vet dhe kjo u ndihmon të bëhen vetë-kritik për punën e tyre, zhvillojnë shkathtësi thelbësore të vlerësimit dhe reflektimit që nevojiten për dhënien e informatës kthyesë, informata kthyesë u ndihmon nxënësve në kryerjen e detyrave dhe i thellon shkathtësitë e tyre para se të vlerësohen nga mësimmshënësi.

Përveç metodave të përmendura më lartë, në procesin e vlerësimit për të nxënë, përdoren edhe metoda/teknika të tilla si rubrikat, shënime anekdotale, tabelat e koncepteve, zhurnalët reflektuese, fletët e kontrollit, diskutime në grup, etj.⁴

Rubrikat

Rubrikat janë një grup përshkrimesh të niveleve të ndryshme të cilësisë së një arritjeje ose aktiviteti që u jepen nxënësve gjatë mësimit ose kryerjes së aktiviteteve në mënyrë që ata të mund të monitorojnë dhe rregullojnë shkallën në të cilën ata kanë zotëruar njohuritë dhe aftësitë e synuara. Ato përdoren në vlerësimin e nxënësve (p.sh. seminar, detyrë ese, ese, diskutim, prezentim, punim kërkimor). Rubrikat përmbajnë përbërës të vlerësimit specifik për përmbajtje ose aktivitete të caktuara, d.m.th. për rezultatet e një lënde individuale. Për secilën komponent, përshkruesit hartohen sipas niveleve të realizimit të kriterëve, të cilat përshkruajnë fushën dhe thellësinë e njohurive dhe shkallën e zhvillimit të aftësive. Më shpesh në kolonën e parë seksionet rendisin përbërësit dhe në rreshtin e parë nivelet e realizimit të kriterëve. Titujt mund të përdoren në shumë qasje të vlerësimit: për të siguruar informata kthyesë, vetëvlerësim, vetërregullim të të nxënës, vlerësim të punës së nxënësve të tjerë dhe për të vlerësuar detyra komplekse; në komunikim me prindërit ose kujdestarët.

Shënime Anekdotale

Shënime anekdotale janë teknika të vëzhgimit dhe mbajtjes së shënimeve të shkurtra të sjelljes dhe punës së nxënësit. Shënime anekdotale janë përshkrime të shkurtra narrative të vëzhgimeve në klasë. Mësuesit mund të zgjedhin të shkruajnë komentet e tyre në etiketa ngjitëse për secilin fëmijë. Kjo i lejon mësuesit të mbajë shënime të shpejta për fëmijët që po vëzhgohen ndërsa lëviz nëpër klasë. Këto shënime më vonë transferohen dhe organizohen në një material që përmban faqe për secilin nxënë. Është e rëndësishme që të merret çdo shënim në mënyrë që progresi të mund të përcillet gjatë një periudhe kohe. Shënime anekdotale mund të përfshihen në disa burime të mësuesve dhe preferenca e mësuesve do të përcaktojë formatin e përdorur për raportime anekdotale. Është e pamundur të përfshihen shënime anekdotale për çdo nxënë çdo ditë, por është e nevojshme një përpjekje e vetëdijshme për të vëzhguar të gjithë nxënësit gjatë një periudhe kohe.

Tabela e koncepteve

Tabelat e koncepteve ofrojnë një paraqitje vizuale të lidhjeve midis koncepteve që nxënësit

4 Për më shumë, shihni “Vlerësimi formativ”, USAID, MASHT, 2013
<https://dokumen.tips/documents/vleresimi-formativ.html>

kanë mësuar. Këto koncepte janë të lidhura me lidhje të drejtuara, të etiketuara për të treguar marrëdhëniet midis tyre. Tabela e koncepteve mund të përdoret kur nga nxënësit diskutohen kategori të cilat mund të krahasohen. Në këto raste mësimdhënësi vizaton një tabelë me përgjigjet e nxënësve dhe i radhitë idetë e tyre sipas kategorive. Zakonisht kjo teknikë aplikohet në fund të orës mësimore, por kjo mund të përdoret edhe gjatë orës dhe për përsëritje. Mësuesi i udhëzon nxënësit si të formohet tabela ose tabela u jepet e gatshme. Në rreshta të tabelës radhiten gjërat që krahasohen, ndërsa në kolona vendosen tiparet që krahasohen. Krahasimet bëhen duke shkruar mendimet brenda katrorëve të kolonave.

Tabelat e koncepteve janë mjete të shkëlqyera që mund t'u japin mësuesve një vlerësim formativ të mësimit pasi nxënësit njihen me materialin e ri. Për shembull, mësimdhënësi mund të postojë një tabelë jo të plotë konceptuale, ku nxënësve u kërkohet të plotësojnë vendet bosh për të ndërtuar një tabelë të plotë, e cila më pas i dorëzohet mësimdhënësit në klasë ose përmes internetit.

Zhurnalët/ditarët reflektues

Përmes zhurnalëve/ditarëve reflektues, nxënësit shkruajnë rregullisht për mësimin e tyre dhe kjo do t'ju ofrojë një burim të vazhdueshëm të vlerësimit formues. Ndihmon gjithashtu në ndërtimin e aftësive metakognitive të nxënësve - aftësinë e tyre për të 'menduar për të menduarit'.

Nxënësit shkruajnë reflektimet e tyre në një orë mësimore, të tilla si ato që mësuan, çfarë u shkaktoi atyre vështirësi, strategjitë që i gjetën të dobishme ose tema të tjera të lidhura me mësimin. Duke lexuar punën e nxënësve të përshkruar në ditar, mësimdhënësit mund të identifikojnë boshllëqet dhe sukseset e nxënësve dhe të klasës në përgjithësi.

Nxënësit priren të jenë më të hapur dhe të sqartë në lidhje me të mësuarit e tyre se sa mund të pritët dhe këto mund të referohen në kriter. Lidhur me zhurnalët/ditarët reflektues, është me rëndësi:

- *Planifikoni një platformë ku zhurnalët/ditarët janë të dukshëm vetëm për ju nëse nxënësit hezitojnë të ndajnë me bashkëmoshatarët e tyre.*
- *Përdorni shënimet e ditarit për të informuar aktivitetet e ardhshme mësimore për individët.*
- *Modeloni procesin e reflektimit për shkrimin e ditarit.*
- *Përdorini pyetjet “Çfarë më interesoi më shumë?” dhe “Cila pjesë ishte më sfiduese?”. Kjo është një mënyrë efektive për të inkurajuar reflektim më të thellë.*
- *Zhurnalët/ditarët reflektues mund të bëhen në një dokument Word në kompjuter ose mund të përdoren platforma elektronike (p.sh. Live Journal ose Blogger), ditarë video ose regjistrime zëri për ndërveprim dhe angazhim më të madh.*

Fletat kontrolluese – listë kontrolli

Fleta kontrolluese përdoret për shkathtësi manovruese të nxënësit dhe është instrument që përmban një listë konceptesh, shkathtësi, shprehje dhe vlera, për të vrojtuar dhe për të matur sa është aktiv nxënësi gjatë punës së pavarur në klasë, laborator apo në punishte. Fleta kontrolluese dëshmon përvetësimin e shkathtësive shprehive dhe vlerave, për një njësi, nënkategori, kategori të përmbytjes programore, ushtrim laboratorik, ushtrim praktik etj. Për secilin nxënësi sa herë që vrojtohet një element nga lista shënohet me ndonjë shenjë p.sh. a,b,c,d, apo: +, -, *, o,. Nëse e shprehim në nota atëherë ato i shoqërojmë duke i shprehur me %, për shkallën e arritshmërisë.

Listat e kontrollit janë më efektive dhe më efikase si një mjet vlerësimi kur vlerësojnë rezultatet specifike të kurrikulës që kanë të bëjnë me një temë. Ato i ndihmojnë mësuesit të përqendrojnë vëzhgimet e tyre dhe të sqarojnë se cilat sjellje janë treguese për të mësuarit e suksesshëm.

Konferenca/diskutimet

Diskutimet me nxënës ose konferencat që nënkuptojnë periudha kohore të caktuara për biseda të planifikuara me nxënës individualisht ose në grupe të vogla janë të vlefshme për të depërtuar në proceset e të menduarit të fëmijëve. Dialogu midis nxënësit dhe mësuesit siguron informacion të vlefshëm në lidhje me të mësuarit e tyre. Përveç vëzhgimeve të rastësishme që kryhen derisa nxënësit punojnë dhe luajnë, ka raste kur kërkohen vëzhgime më të thelluara dhe konferenca për mbledhjen e informacionit specifik. Një konferencë mund të ndodhë gjatë përfshirjes në biseda me një nxënës në lidhje me rendin e ngjarjeve në një histori që ata kanë lexuar, duke luajtur një lojë me nxënës për të mbledhur informata për tema të ndryshme që i kanë mësuar. Gjatë kohës sa nxënësit dhe mësuesi janë të përfshirë në këto diskutime, mund të merren shënime anekdotale për qëllime vlerësimi.

Për realizim të metodave dhe teknikave të përmendura më lart, mund të përdoren platformat dhe instrumente të ndryshme digjitale për të mbështetur vlerësimin formues në klasë⁵.

Nuk ka një sistem vlerësimi që është më i miri për klasën. Çka funksionon për një situatë mund të mos funksionojë në një tjetër. Ajo që është e rëndësishme është se vlerësimi është një aktivitet i vazhdueshëm, një veprim i cili mbështetet në strategji dhe burime të shumta për mbledhjen e informacionit që ka të bëjë me cilësinë e punës së nxënësit dhe që më pas mund të përdoret për të ndihmuar nxënësit dhe mësuesin për një proces më të mirë të të nxënës.

5 Linku më poshtë përmban 75 platforma dhe instrumente dixhitale të cilat mund t'i kombinoni me metodat dhe teknikat e ndryshme për vlerësim:<https://ëëë.nëea.org/blog/2019/75-digital-tools-apps-teachers-use-to-support-classroom-formative-assessment>

4 FORMAT E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE NË KUSHTET E PANDEMISË COVID 19

Vlerësimi në kohë pandemie, ka të bëjë me mbështetjen e mësimit të nxënësve që nënkupton përqendrimin në raportim për arritjet në objektivat e caktuara dhe udhëzimet për përmirësim në mësim, në vend të vlerësimit për një notë. Do të thotë të ndihmohen nxënësit të shohin vlerësimet si mjet mësues që kanë një rol integral në procesin e të nxënës, sesa si pajisje vlerësimi që shënojnë fundin e mësimit. Do të thotë të jepet sqarimi për nxënësit se qëllimi kryesor i vlerësimeve është të verifikojë se çfarë ata kanë mësuar dhe të identifikojnë ndonjë problem të mësimit, në mënyrë që të mund të punojnë së bashku për të korrigjuar ato probleme. Prandaj, mashtrimi i një vlerësimi nuk shërben për qëllim tjetër përveç se të vonojmë përpjekjet për t'i ndihmuar të gjithë nxënësit të mësojnë mirë.

Mësimdhënësit duhet mbajtur shënime për temën e shtjelluar për çdo orë, në mënyrë të veçantë për orët e mësimit në distancë, pjesëmarrjen/mospjesëmarrjen e nxënësve në mësim duke evidentuar arsyet përkatëse dhe duhet të raportojnë te drejtori. (kjo mund të bëhet në marrëveshje brenda shkollës për kohën dhe mënyrën e raportimit).

- Nxënësit duhet të kenë kohë të mjaftueshme për kryerjen e detyrave pa presion. (nuk duhet caktuar afat i shkurtër kohor për kryerjen e tyre, por duhet caktuar një kohë që është e përshtatshme për të gjithë nxënësit).
- Vlerësimi i nxënësve bëhet përmes informatave kthyesë për aktivitetet e ndryshme mësimore (si detyra të shtëpisë, ushtrime, hulumtime).
- Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve bëhet vetëm me vlerësim formativ përmes shënimeve të mbajtura të mësimdhënësit në fletoren personale edhe gjatë periudhës kur nxënësit vijojnë mësimin në shkollë, e po ashtu edhe me vlerësimin që mësimdhënësi kryen gjatë mësimit online, duke përfshirë detyrat e shtëpisë, angazhimin dhe gatishmërinë e tyre për të komunikuar (me debat, prezentim me gojë) në orën fizike dhe virtuale.
- Në këtë situatë të krijuar nxënësve ju duhet më shumë kohë për të perceptuar përmbajtjen e të mësuarit në këto skenarë për arsye tashmë të njohura kështu që është shumë e rëndësishme që vlerësimi të bëhet përmes informatave kthyesë të performancës (vlerësim formativ) për tërë klasën ose për grupe individuale brenda klasës për aktivitetet e ndryshme mësimore (si detyra të shtëpisë ushtrime, hulumtime). Duhet të merret në konsideratë mundësia e caktimit të një kohe të paraparë për mësim të drejtpërdrejtë të mësimdhënësit me nxënësit që kanë nevojë për përmirësim apo kanë pyetje shtesë duke ju dhënë sqarime dhe mbështetje të vazhdueshme nëse është nevoja edhe individualisht.
- Është e rëndësishme që mësimdhënësit të vlerësojnë edhe njohuritë e fituara përmes vlerësimit formativ duke inkurajuar dhe motivuar nxënësit, duke i nxitur ata që të punojnë me seriozitet dhe në bazë të njohurive të fituara gjatë mësimit në distancë/online dhe punës së tyre në shtëpi që të orientohen në angazhimin e tyre të mëtejshëm.

Vlerësimi i nxënësve nuk do të jap vlerësim të qëndrueshëm nëse nuk planifikohet të rishikohet dhe të veprohet në lidhje me rezultatet do të duhej që struktura e ekipit të vlerësimit (mësimdhënësit e aktiveve profesionale) të kenë aftësi për të mbështetur rishikimin e vlerësimit në bazë të të dhënave të dala nga rezultatet.

Menjëherë pas vlerësimit të nxënësve mësimdhënësit mund të shohin performancën e nxënësve në raport me kërkesat e parashtruara në bazë të planifikimeve të tyre dhe deri diku të bëjnë krahasimin e performancës së nxënësve nga vitet e mëparshme duke zbuluar shtrirjen e arritjeve të tyre gjatë kohës së izolimit në kohën e pandemisë. Kjo kohë detyron shkollat për

një plan të vlerësimit, në të cilin përveç aspekteve që mbulohen lidhur me aspektet kryesore të vlerësimit, bartësit, dinamika e vlerësimit/afatet, përcaktohen edhe format e vlerësimit, si bazë për të zhvilluar instrumente të vlerësimit në përputhje me format përkatëse të vlerësimit.

4.1 Vlerësimi diagnostifikues

Testet diagnostikuese – Vlerësimi diagnostifikues është i përshtatshëm për t'i mundësuar mësimdhënësve veprim sipas nevojave të nxënësve. Testi diagnostifikues ofron informacione mbi performancën e nxënësve, identifikon aftësitë individuale të nxënësve gjë që do t'u ofrojë mësimdhënësve pasqyrë të plotë të performancës së nxënësve, të cilin do ta përdorin për të identifikuar vështirësitë e nxënësve në procesin e të nxënësve. Mësimdhënësit duhet të formulojnë nivelin e vështirësive që e kanë identifikuar te nxënësi, por duhet pasur kujdes që të dhënat të jenë të sakta duke identifikuar natyrën e vështirësive dhe për vështirësitë në të nxënë të njoftojë nxënësit. Shqyrtimi mund t'u jepet nxënësve, me një qasje përmirësuese duke përshkruar saktë udhëzimet për përmirësimin e të nxënësve. Mësimdhënësit duhet të sigurohen për të maksimalizuar potencialin e mësimin të materialeve të caktuara (temave që dalin nga rezultatet e të nxënësve K.B.). Mësimdhënësit udhëzojnë nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur, në mënyrë që të zhvillojnë aftësitë e tyre në formë të strukturuar, që të përshpejtojnë ngritjen e performancës së tyre nëpër mjet të të mësuarit individual për secilin nxënë. Mësimdhënësit duhet të mbështesin nxënësit duke ju dhënë udhëzime të drejtpërdrejta për përdorimin e burimeve dhe mjeteve mësimore.

4.2 Vlerësimi formativ

Vlerësimi formativ – realizohet gjatë gjithë vitit shkollor nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm dhe vlerësimit përfundimtar. Vlerësimi ka të bëjë me tërësinë e mjeteve, të teknikave, të metodave dhe të praktikave të përdorura nga mësimdhënësit për të testuar, kontrolluar, analizuar dhe matur nivelin e njohurive, aftësive dhe performancës së nxënësve. Mësimdhënësit përzgjedhin instrumente të vlerësimit si angazhimi në klasë, detyrat e shtëpisë, prezentimet me gojë, detyrat individuale, testet, listat kontrolluese, posterët, debatet, esetë, kuizet, portfoliot, projektet, puna praktike, puna laboratorike, projektet dhe vëzhgimi i mësimdhënësve. Në përzgjedhjen e këtyre instrumenteve të vlerësimit, mësimdhënësit duhet të marrin parasysh ekuilibrin e rezultateve të të nxënësve dhe format dhe metodat e mësimdhënies. Mësimdhënësit duhet të japin informata për cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënësve, përparimin e nxënësve nëpërmjet udhëzimeve dhe detyrave me mesazhe me tekst qoftë në mënyrë fizike në shkollë, qoftë me postë elektronike nëpërmes platformave digjitale.

Këto instrumente të vlerësimit duhet të jenë të ndryshme në varësi të llojeve të të nxënësve që do të vlerësohen dhe duhet të plotësohen në baza të vazhdueshme dhe periodike.

4.3 Vlerësimi përmblledhës

Vlerësimi përmblledhës realizohet në periudhat mësimore gjatë vitit mësimor në bazë të rezultateve të të nxënësve, që arrihen në periudhën përkatëse, me instrumente të ndryshme, të hartuara sipas kritereve të caktuara të vlerësimit.

Rezultatet e vlerësimit përmblledhës evidentohen me komente dhe nota për nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënësve. Nota e vlerësimit përmblledhës për një periudhë të caktuar mësimore

formohet prej vlerësimit të vazhdueshëm dhe vlerësimeve përmbledhëse të periodave mësimore. Nota duhet të jetë gjykim i mësimdhënësit bazuar në dëshmitë e evidentuara në ditarin e tyre personal dhe rezultateve të arritura në vlerësimin përfundimtar. Instrumentet e vlerësimit përfundimtar:

Kërkesat me shumë alternativa – shumica e mjediseve mësimore kanë mjete për të përdorë këtë lloj të vlerësimit. Hartimi ose përgatitja e testeve me zgjedhje të shumëfishta (në internet ose në ambientet shkollore) do të ndikojnë qartë në kohën që duhet për të rishikuar vlerësimin, duhet pasur kujdes që vendosja e pyetjeve të zgjedhura mirë të vlerësojnë më shumë sesa thjeshtë aftësinë për të zgjedhur përkufizimin e saktë. Testimi online duhet të ketë një numër më të madh të pyetjeve të cilat do të përzgjidhen nga mësimdhënësi në momentin e caktuar, po ashtu kombinimet duhet të ndryshohen, për të ulë rrezikun e komunikimit të nxënësve, por padyshim që është e nevojshme për t'u siguruar që të gjitha pyetjet të jenë me vështirësi të krahasueshme.

Teste të standardizuara - Këto teste përdoren gjerësisht në shkolla. Këto i referohen normës ose kriterit dhe shoqërohen me leximin aftësitë e të kuptuarit, zbatimin dhe analizën. Testet e standardizuara kontribuojnë në saktësinë e monitorimit të mësimdhënësit dhe ndihmojnë për të identifikuar nevojat e nxënësve dhe objektivat e duhura të mësimit që ata kërkojnë. Testimi i standardizuar i nxënësve duhet ta lehtësojë planifikimin e shkollës dhe planifikimin e mësimdhënësit duhet ta lehtësojë, në mënyrë periodike gjatë procesit mësimor si pjesë e një procesi më të gjerë vlerësimi.

5 MODALITETET E VLERËSIMIT NË RASTE SPECIFIKE

Në kapitujt 3, 4 janë prezentuar qasjet e vlerësimit në raport me tre skenarët e organizimit të mësimi, metoda të vlerësimit, forma të vlerësimit dhe rekomandime të përgjithshme për vlerësimin, të cilat, me pak modifikime, mund të aplikohen për të gjitha grupmoshat dhe lëndët mësimore. Ndërkaq, kapitulli 5, zbërthen disa modalitete të vlerësimit për raste specifike, siç janë nivelet e ndryshme të shkollimit, lëndët artistike dhe fëmijët me nevoja të veçanta. Mësimdhënësit mund t'u referohen pjesëve të veçanta të kapitullit 5, varësisht nga nevojat e tyre, pa qenë të detyruar t'i lexojnë edhe ato pjesë që nuk kanë të bëjnë me detyrat e tyre të punës. Megjithatë, është e domosdoshme që, para se të përzgjedhë çfarë do të lexojë nga kapitulli 5, secili mësimdhënësi **t'i lexojë me kujdes dhe në tërësi të gjithë kapitujt tjerë të këtij Udhëzuesi.**

5.1 Vlerësimi në nivelin parashkollor\parafillor

Vlerësimi në fëmijërinë e hershme bëhet për të mbledhur informacion rreth zhvillimit dhe të nxëniti të fëmijës, nga mjedisi mundësues dhe nga gjithë veprimtaria edukative që organizohet nga edukatorët dhe prindërit, me qëllim mbështetjen dhe ndihmën për fëmijën në procesin e zhvillimit dhe të nxëniti të tij. Veprimtaritë dhe aktivitetet e përditshme si përfshirja dhe angazhimi në lojë dhe aktivitete individuale apo në grupe (me fëmijë dhe të rritur), vizatimi, këndimi, vallëzimi, ndërtimi i blloqeve, bisedat me fëmijë dhe të rritur, ushtrimet fizike, ushqimi, pushimi, etj., janë bazë e vlerësimit në fëmijërinë e hershme. Referuar këtyre kërkesave dhe kushteve të edukimit në distancë, vlerësimi në fëmijërinë nuk mund të bëhet pa bashkëpunimin me prindërit.

Mjedisi dhe gjendjet emocionale të fëmijëve mund të ndikojnë në pjesëmarrjen dhe angazhimin e fëmijës në veprimtari edukative, prandaj këto duhet të merren në konsideratë gjatë vlerësimit në fëmijërinë e hershme, pra edhe në nivelin parashkollor dhe klasën parafillore. Vlerësimi i fëmijëve në vitet e fëmijërisë së hershme është relativisht sfidues. Procesi i vlerësimit të asaj që fëmijët e vegjël dinë dhe mund të bëjnë, paraqet sfida të veçanta dhe vlerësimi i fëmijëve shpesh është “jo i besueshëm”, pasi performanca e fëmijëve të vegjël nuk është domosdoshmërisht e qëndrueshme edhe për periudha të shkurtra kohore. Ndikimet e ambientit dhe gjendjet emocionale të fëmijëve mund të ndikojnë në mënyrën se si ata dalin në vlerësime. Për më tepër, fëmijët e vegjël zhvillohen me ritme shumë të ndryshme dhe modelet e tyre të zhvillimit dhe të nxëniti mund të jenë episodike, të pabarabarta dhe të shpejta.

Është e rekomandueshme që vlerësimi tek fëmijët e moshës parashkollore të përqendrohet në:

- situatat reale që pasqyrojnë atë çka fëmija bën aktualisht;
- vëzhgimet dhe detyrat që ndodhin në kontekstin e lojës së rregullt ose aktiviteteve;
- interaktivitetin e fëmijëve që rezultojnë në informacion rreth aftësisë së fëmijëve për të ndërvepruar me mjedisin e përditshëm;
- origjinalitetin e sjelljes, duke krijuar mundësi të shumëfishta e të shpeshta për të treguar një sjellje ose aftësi, e të tjera.

Duke pasur parasysh situatën e krijuar me pandeminë COVID-19, MASHI, nga data 15.04.2020, ka lansuar platformën online “Edukimi në distancë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç”. Kjo platformë është krijuar, me qëllim

të mbështetjes së prindërve/kujdestarëve ligjorë, fëmijëve dhe edukatorëve në realizimin e aktiviteteve ditore me fëmijët në kushte shtëpie. Përmbajtja e aktiviteteve të prezentuara në këtë Platformë, stimulon fëmijët në zhvillimin e tyre në të gjitha fushat zhvillimore në varësi të moshës së tyre si në atë fizike, njohëse, emocionale, matematikore dhe të kreativitetit. Andaj, aktivitetet që do të realizohen gjatë kësaj periudhe në kushte shtëpie për fëmijët e moshës 0-6 vjeç, do të realizohen nga prindërit\ kujdestarët ligjorë, bashkë me fëmijët e kësaj grup-moshe.

Pjesë e platformës online është edhe Formulari i Raportimit të edukatoreve në baza javore. Ky raport plotësohet nga edukatorët e grupit për të dëshmuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre për prindërit gjatë realizimit të aktiviteteve ditore/javore, në kushte shtëpie të paraqitura në platformën Edukimi në distancë-Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç. Edukatorët përmes këtij raporti, do të përshkruajnë aktivitetet javore të realizuara sipas platformës online, përcjellin përmes bashkëpunimit me prindërit/kujdestarët ligjor, numrin e fëmijëve të angazhuar në aktivitete përmes mjeteve dhe platformave të ndryshme teknologjike dhe në dosjen e secilit fëmijë do të reflektojnë mbi aktivitetet e javës dhe përfshirjen e fëmijëve në këto aktivitete duke dëshmuar edhe me fotografi angazhimin e fëmijëve. Pra, në këtë periudhë edukatoreve të të gjitha grup-moshave, do t'ju duhet të krijojnë dosjet (portfoliot) për secilin fëmijë të grupit, e cila është mjet i rëndësishëm për të komunikuar jo vetëm për të mësuarit e një fëmije, por gjithashtu për të ofruar dëshmi për të mbështetur konkluzionet e edukatoreve në lidhje me pikat e forta, aftësitë dhe shkathtësitë e fëmijëve.

Dosja përmban shembuj të punës së fëmijëve në angazhimin e tyre në aktivitete në fusha të ndryshme përgjatë kësaj periudhe të qëndrimit në familje. Këta shembuj duhet të përfaqësojnë punën tipike të fëmijës (jo vetëm më të mirën ose më të keqen) dhe të tregojnë procesin e angazhimit të fëmijëve (jo vetëm produktin final). Po ashtu, dosjet përmbajnë edhe shënime të shkurtra, domethënëse, faktike nga edukatorët, të dala nga vëzhgimi i fëmijëve, ose nga informacionet që ka marrë nga prindi/kujdestari. Dosja duhet të ofroj informacion se si fëmijët janë duke përparuar në një fushë të caktuar ose në zhvillimin e një aftësie. Sa më e pasur të jetë dosja e fëmijëve me “punë” të fëmijëve, aq më lehtë do ta ketë edukatorja në mbështetjen dhe për të vërejtur dhe për të qenë e sigurt në përparimin e tyre.

Për t'iu përgjigjur situatës së krijuar, për këtë vit do të jetë i mjaftueshëm vlerësimi përshkrues vjetor i fëmijëve sipas fushave të zhvillimit

Vlerësimi në edukimin e hershëm mbështet në Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-5 vjeç, ne këtë mënyrë edukatorët përmes vëzhgimit, përmes dosjes së punës së fëmijëve, dokumentimit bëjnë vlerësimin përshkrues të cilin e evidentojnë në librin e grupit edukativ, i cili bëhet në fund të vitit edukativ\shkollor, duke ju referuar fushave të zhvillimit të fëmijëve.

Ndërsa, klasa përgatitore parafilllore, mosha 5-6 vjeçare e fëmijëve te nivelit 0, është pjesë e shkallës së parë të kurrikulës bërthamë për nivelin 1. Vlerësimi i fëmijëve në klasën parafilllore bëhet me qëllim të matjes në arritjen e rezultateve të të nxënës për lëndë të cilat kontribuojnë në arritjen e rezultateve të fushave kurrikulare (Rezultatet e kompetencave dhe të fushave maten në fund të klasës së 2-të). Vlerësimi i fëmijëve në klasën përgatitore, evidentohet në librin e klasës, bëhet përmes përshkrimit që tregon nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënës dhe raportohet me komente konstruktive që motivojnë dhe orientojnë përparimin e fëmijëve. Edhe vlerësimi në klasën përgatitore mbështetet në standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6, bëhet përmes dokumentimit dhe vëzhgimit, përmes dosjes së punës së fëmijëve. Vlerësimi i fëmijëve në klasën përgatitore edukimin parashkollor bëhet në tri periudha, e para në fund të janarit, e dyta në fund të marsit dhe e treta në fund të vitit edukativ\shkollor, i cila do të realizohet me ndihmën e dosjes së fëmijëve, të dhëna këto që do të mblidhen gjatë realizimit të aktiviteteve të realizuara në institucion parashkollor\klasë parafilllore dhe nga edukimi në distancë.

5.2 Vlerësimi në arsimin fillor

Vlerësimi i arritjeve të nxënësit në arsimin fillor (klasat 1-5) sipas tre skenarëve të organizimit të procesit mësimor (shih kapitullin 2) duhet të bëhet duke u mbështetur në aktivitetet mësimore të zhvilluara, si dhe punën e pavarur në klasë/shtëpi të secilit nxënës. Mësuesi/ja, përmes aktiviteteve mësimore që zhvillon me nxënësit e tij/saj dhe përmes vlerësimit të njohurive, aftësive, shkathtësive, vlerave e qëndrimeve, duhet të sigurojë baraspeshë në mes të kërkesave të kurrikulës në arsimin fillor (klasat përkatëse) dhe rrethanave të mësimiit dhe vlerësimit në distancë. Kjo nënkupton që mësuesi/ja edhe në këto rrethana duhet t'i angazhojë nxënësit përmes aktiviteteve të ndryshme që e ndihmojnë të vlerësojë përparimin e secilit nxënës në përditësimin e shkrim-leximit themelor, matematikës elementare, njohjes së mjedisit natyror e shoqëror, etj., edhe në kushtet e mësimiit në shtëpi.

Rekomandohet që në arsimin fillor (klasat 1-5) sipas tre skenarëve të organizimit të mësimiit (shih kapitullin 2) të vlerësohen rezultatet thelbësore të të nxëniti që në fokus kanë komunikimin në gjuhën amtare, leximin, shkrimin dhe llogaritjet me numra, përdorimin e drejtë të simboleve, zgjidhjen e problemeve, të shprehurit kreativ, etj. Mësuesit duhet të bëjnë kujdes të mos i mbingarkojnë nxënësit me detyra të shumta, në mënyrë të veçantë me detyra që nuk mund të kryhen në kushtet e shtëpisë, që nuk mund të kryhen në mënyrë të pavarur nga fëmijët dhe me të cilat nuk mund të vlerësohet puna e pavarur e nxënësve.

Secili mësues është i obliguar që të mbajë kontakte direkte me nxënës, përmes prindërve ose kujdestarëve ligjor, ta përcjellë përparimin e nxënësit dhe t'i ofrojë informata kthyesë inkurajuese për përparimin në mësim, mangësitë eventuale, orientimet ku duhet të fokusohet të nxëniti dhe mënyrën si të mësojë, etj. Gjatë mësimiit në distancë, informatat kthyesë për nxënësit në arsimin fillor rekomandohet të jenë me gojë dhe me shkrim dhe të ofrohen përmes platformave që mësuesja/i i përdor me nxënësit e tij/saj.

Meqenëse, bazuar në kërkesat e mësimiit online secili nxënës duhet t'i dërgojë te mësuesi/ja detyrat me shkrim, ilustrimet, skicat dhe punimet tjera, atëherë secili mësues/e duhet t'i ruaj ato në portfolio të nxënësit përkatës për qëllime të vlerësimit. Në kushte të tanishme, portfoliot e tilla duhet të jenë elektronike dhe mësuesi/ja duhet të organizojë skedarë (folderë) të veçantë në kompjuter për secilin nxënës dhe lëndë ku do të ruhen punimet e nxënësve. Pastaj, bazuar në përmbajtjen e portfolios së nxënësit: sasinë, cilësinë, kreativitetin dhe origjinalitetin e tyre mësuesja/i, bën vlerësimin përshkrues për nxënës/e/in, për klasat 1-2), ndërsa për nxënësit e klasave 3,4,5 bën vlerësimin e tyre me notë.

5.3 Vlerësimi në arsimin e mesëm të ulët

Mësimdhënësit e arsimit të mesëm të ulët (klasat 6-9), përmes formave të ndryshme të mësimiit sipas skenarëve të organizimit të procesit mësimor, janë të angazhuar për t'i ndihmuar nxënësit për realizimin e detyrave sipas udhëzimeve të dhëna në kapitullin 2 të këtij dokumenti varësisht se si do të realizohet procesi mësimor. Ata, shpjegojnë pjesët e përmbajtjeve, ndajnë me nxënësit materiale të përgatitura, sqarojnë detyrat dhe

monitorojnë pjesëmarrjen e nxënësve në mësim. Përveç kësaj, mësimdhënësit duhet të vlerësojnë njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve për plotësimin e kërkesave të kurrikulës, (bazuar në kapitullin 2 të këtij udhëzuesi, ndërsa për metodat dhe format e vlerësimit të nxënësve duhet të mbështeten në kapitullin 3 dhe 4).

Duke marrë parasysh kushtet në të cilat zhvillohet procesi mësimor, materialet dhe burimet e tjera të nevojshme për zhvillimin e mësimi, metodat e vlerësimit duhet të jenë të arsyeshme dhe në interesin më të mirë të nxënësve. Prandaj, është e nevojshme të shmangen metodat e vlerësimit që realizohen me vështirësi apo që mund të dëmtojnë shëndetin mendor dhe mirëqenien e nxënësve. Me rëndësi është të vlerësohen shkathtësitë e nxënësve përkryerjen e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve, e jo njohuritë për përmbytjet. Në të gjitha lëndët, mësimdhënësit duhet të jenë të kujdesshëm në përzgjedhjen e detyrave dhe aktiviteteve, në mënyrë që ato të jenë stimuluese dhe në të njëjtën kohë në shërbim të sintetizimit të njohurive të tyre. Pritet që fokusi të jetë në detyrat nga matematika, gjuha, shkencat e natyrës dhe ato sociale, por edhe në integrimin mes lëndëve. Secili mësimdhënësi i lëndës/ve mësimore, duke u bazuar edhe në përcjelljen e vazhdueshme paraprake dhe përcjelljen e tanishme mban shënime për të gjitha metodat dhe teknikat e vlerësimit dhe për veprimtaritë e nxënësve në ditarin personal. Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit është pjesë e autonomisë dhe e përgjegjësisë së secilit mësimdhënësi, por në këtë periudhë ata duhet që në planifikimet e tyre të identifikojnë rezultatet thelbësore të të nxënësve mbi të cilat do të përcaktojnë objektivat e vlerësimit të arritjeve të nxënësve.

Gjatë mësimi përparësi ka vlerësimi i bazuar në metodat inovatore (shih. 4.2) të cilat mundësojnë aktivizimin e nxënësve dhe angazhimin e tyre në diskutime gjatë mësimi. Për të ndihmuar nxënësit, e sidomos ata që kanë nevojë për më shumë mbështetje, informatat kthyesë për punën e bërë të nxënësve konsiderohet të jenë thelbësore. Është me rëndësi që informatat kthyesë të përqendrohen në atë që duhet të bëjnë nxënësit për të përmirësuar punën e tyre, e jo të jenë gjyquese. Informatat kthyesë duhet të jepen me kohë dhe të jenë pozitive (të fillohen gjithmonë me një koment nga aspekti pozitiv), të jenë të detajuara (të përmbajnë informata dhe sqarime që u ndihmojnë nxënësve për të përmirësuar punën e tyre), realiste (të marrin parasysh mundësitë dhe rrethanat në të cilat mëson nxënësi), dhe të jenë motivuese (përdorimi i fjalëve të përshtatshme dhe inkurajuese është nxitje për të punuar më të mirë në të ardhmen). Sipas nevojës dhe mundësisë, mësimdhënësi/ja mund të regjistrojë një video që u shërben nxënësve për të marrë informata kthyesë dhe komente për ndonjë problem të veçantë ose paqartësi që kanë pasur një numër i madh i tyre.

Për këtë nivel, prindërit, gjithashtu kanë një rol shumë të rëndësishëm. Ata duhet bërë përpjekje për gjetjen e mënyrave për të ndihmuar fëmijët e tyre, duke u angazhuar për sigurimin e mjeteve dhe burime të nevojshme për mësim, duke i frymëzuar dhe inkurajuar ata për të mësuar. Në shumë raste, prindërit mund t'i ndihmojnë fëmijët duke krijuar një lidhje midis asaj që ata po mësojnë dhe përvojave të përditshme. Prandaj, çdo herë që është e mundur, komunikimi dhe bashkëpunimi me prindërit duhet të kontribuojnë në vetëdijësimin e nxënësve për marrjen e përgjegjësisë për të nxënësit e tyre.

5.4 Vlerësimi në arsimin e mesëm të lartë

Institucionet e arsimit të mesëm të lartë (klasat 10-12) kanë përgjegjësi të plotë për organizimin e procesit mësimor gjatë kohës së pandemisë. Prandaj, është detyrë dhe përgjegjësi profesionale e aktivave profesionale dhe secilit mësimdhënësi që ta

bëjë përzgjedhjen e përmbajtjeve më të rëndësishme, të domosdoshme për arritjen e kompetencave të nxënësve dhe që mund të zhvillohen në kushtet e imponuara nga pandemia. Këto rezultate të të nxënësve dhe rezultatet e kompetencave duhet të jenë bazë për vlerësimin e arritjeve të nxënësve.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, në rrethanat e pandemisë, duhet shfrytëzuar si një mundësi për të motivuar nxënësit për mësim, për të mbështetur të nxënësve me informata kthyesë për detyrat, projektet e aktivitetet tjera, për të orientuar punën e mëtejme, por edhe për të gjykuar shkallën e pavarësisë dhe arritjes së kompetencave të tyre.

Kompetencat, aftësitë e nxënësve të arsimit të mesëm të lartë për përdorimin e teknologjisë së informacionit si dhe të platformave dhe burimeve të ndryshme dhe punës së pavarur, janë përparësi që duhet shfrytëzuar nga mësimdhënësit e gjimnazeve për të aplikuar qasje të mësimdhënies ndërvepruese që nxisin dhe motivojnë nxënësit të jenë aktivë gjatë gjithë mësimin në distancë. Kjo është edhe njëra ndër kompetencat e Kornizës së Kurrikulës, prandaj detyrë e secilit mësimdhënësi është që ta verifikojë dhe ta vlerësojë këtë kompetencë. Kompetenca tjetër e rëndësishme e Kornizës që duhet vlerësuar në këtë nivel të shkollimit është edhe të nxënësve për të nxënë, e cila ka të bëjë me aftësinë e të nxënësve për ta vetorganizuar të nxënësve, për të gjetur burimet, për t'i sistemuar njohuritë e fituara dhe për t'i shfaqur ato.

5.4.1 Vlerësimi në arsimin profesional

Për lëndët e përgjithshme dhe pjesën teorike të lëndëve profesionale, vlerësimi në kushtet e organizimit të mësimin në kohë pandemie është si edhe për të gjitha shkollat e mesme të larta (Kapitujt 3,4 dhe 5). Ndërkaq, vlerësimi në lëndët profesionale, ku puna praktike ka një rëndësi të veçantë, kërkon një qasje më specifike. Në kushte të tanishme, edhe pse janë bërë përpjekje të mëdha organizimi i punës praktike për një numër të konsiderueshëm të profileve është i pamundur. Aty ku nuk ka mundësi të organizohet puna praktike, vlerësimi i nxënësve bëhet duke ju dhënë detyra specifike sipas planprogramit mësimor për të kuptuar nëse nxënësit posedojnë njohuri, shkathhtësi dhe kompetencë për të qenë në gjendje t'i zbatojë detyrat edhe në praktikë. Në vend që t'i thuhet nxënësit “bëje këtë veprim”, në kushte të tilla, si detyrë do të kërkohej nga ai/ajo të bëjë përshkrimin në detaje të një procesi veprues. Më këtë mësimdhënësi do të nxjerrë përfundime, në ç' masë e ka kuptuar nxënësi përmbajtjen, procesin e veprimit dhe nëse do ta kishte rastin, sa do ishte në gjendje ta zbatonte në praktikë.

Shembull: Në mësimin praktik, nxënësi do të kishte për detyrë ta rregullonte një pajisje, e cila nuk funksionon për një arsye të caktuar. Meqë gjatë mësimin në distancë kjo është pothuajse e pamundur, atëherë nxënësve do t'u jepej si detyrë ta bëjnë përshkrimin se si do e bënin rregullimin e asaj pajisjeje, çfarë do të bënin, çfarë mjete pune do të përdornin, çfarë materiali do të ishte i nevojshëm, sa kohë do të duhej për ta rregulluar, etj. Për detyra të caktuara mund të kërkohej skica, vizatime që lidhen me hapat e punës praktike, si në këtë shembull të përshkruar.

Megjithatë, ka raste kur puna praktike mund të realizohet edhe me mjete dhe materiale që janë në dispozicion në shtëpi, për shembull: programimi në kompjuter, puna në firma ushtrimore, dizajni, e të ngjashme. Në raste të tilla, detyrat duhet të jenë të lidhura me

praktikën që ka mundësi ta bëjë nxënësi në shtëpi, duke vlerësuar procesin e kryerjes së një detyre praktike, por edhe produktin, për shembull: kodin programor, dokumentacionin e firmës ushtri- more, dizajnin e një objekti të caktuar, etj.

5.5 Vlerësimi në lëndët artistike

Megjithëse lëndët nga fusha e arteve nuk trajtohen me përparësi gjatë zhvillimit të mësimin në pandemi, përfshirja e nxënësve në këto lëndë ndikon në mirëqenien e tyre, si dhe në zhvillimin e shkathtësive /kompetencave artistike dhe njohjen e koncepteve/ dukurive, teknikave dhe proceseve artistike.

Kështu, këndimi dhe luajtja në instrumente, si forma mësimi dhe vlerësimi, mund të realizohen edhe përmes aplikacioneve të zakonshme për komunikim, por edhe me shfrytëzimin e disa aplikacioneve të veçanta për muzikë e incizim. Krijimi artistik muzikor ose pamor mund të demonstrohet në kohë reale, por edhe të dokumentohet me foto ose video që ruhen në portfolio.

Format tjera, si poster, reflektimi për vepra të caktuara, krijues, performanca, ekspozita, mund të punohen me shkrim nga nxënësit dhe të dorëzohen brenda afatit të caktuar.

Kriteret për vlerësim janë të veçanta për çdo instrument vlerësimi dhe vlejné në përgjithësi kriteret e përgjithshme për komentimin, hulumtimin, prezentimet me shkrim(ese), posterin si dhe kriteret për vlerësimin e produkteve artistike konkrete (këngë, luajtjen në instrument, vizatimin, pikturën e produktet tjera artistike).

5.6 Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta është proces kompleks dhe kërkon të përdoren shumëllojshmëri të metodave dhe teknikave të vlerësimit në mënyrë që t'u jepet mundësia të demonstrojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre. Këtij kompleksiteti i shtohet edhe vështirësia e mësimin në pandemi, pasi që kërkon edhe shkathtësi digjitale dhe format e mësimin janë të kombinuara. Për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta sidomos gjatë mësimin në distancë, duhet të përdorim metoda dhe teknika që funksionojné dhe përmes të cilave sigurohen informata kthyesë të mjaftueshme për të vlerësuar progresin e nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta që punojné me kurrikulë/programet lëndore bëhet sipas udhëzimeve që janë dhënë në kapitujt e mësipërm të këtij dokumenti.

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta të cilët punojné me Plan Individual të Arsimit (PIA) dhe lëndë të individualizuara bëhet me anë të portfolios. Në rastet kur mësimi ofrohet në distancë, mësimdhënësit për secilin rezultat mësimor të planifikuar ofrojnë udhëzime, detyra dhe materiale konkrete për prindër. Puna dhe aktiviteti i nxënësit duhet të dëshmohet nga prindi, ndërsa edukatorja, mësimdhënësi i klasës apo mësimdhënësi lëndor duhet të krijojë portfolion elektronike të secilit nxënësi.

Për fëmijët/ nxënësit me nevoja të veçanta rezultatet e synuara ndahen në hapa të vegjël

dhe të thjeshtë që puna e nxënësit të jetë konkrete dhe e matshme. Për secilin hap të punës që synon arritjen e rezultatit individual duhet të jene të paktën dy dëshmi të punës së nxënësit p.sh: foto, video, etj. Mësimdhënësit, gjithashtu duhet të mbajnë listën e kontrollit të detyrave që siguron mbarëvajtjen e përfundimit të aktiviteteve/detyrave të nxënësit në kohën e caktuar.

Për fëmijët/nxënësit në Qendra Burimore dhe në institucione parashkollore të cilët përdorin Programin me fusha të aktiviteteve (niveli parafillor) vlerësimi bëhet sipas udhëzimeve të programit dhe përdoren 3 formularë.

Formulari 1 Shënohen informatat për zbërthimin e aftësive në hapa, plotësohet nga mësuesi, /prindi/kujdestari e rikthen formularin e plotësuar te mësuesi/ja dhe vazhdimisht këshillohet në procesin e realizimit të aftësive. Në rast që për shkaqe objektive nuk mund të kthehet formulari i plotësuar, atëherë kjo dëshmohet përmes fotove, video- incizimeve apo edhe në bazë të konsultimit/bisedës me telefon.

Formulari 2 Shërben për evidentimin e të dhënave për zhvillimin eshkathtësive për secilin fëmijë. Mësuesja nga Formulari 1 përcjell të dhënat në Formularin 2 të cilin e miraton mësuesi/sja, drejtori i shkollës dhe në fund të muajit e dorëzon një kopje të prindërit.

Formulari 3 Shërben për evidentimin e arritjeve në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor për secilin fëmijë.

Vlerësimi i nxënësve të verbër, me dëmtime në të parë dhe nxënësit me dëmtime në dëgjim, parimisht është i njëjtë si i gjithë nxënësve tjerë. Nxënësit me dëmtime në të parë përdorin pajisjet teknologjike dhe komunikojnë online me tekst, me zë apo me video. Në këtë kuptim në pjesën më të madhe opsionet e vlerësimit në distancë që janë dhënë në kapitujt e mësipërm mund të përdoren për këto dy kategori të nxënësve.

Për nxënësit e verbër mund të përdoren edhe forma specifike të vlerësimit si: pyetje përgjigje me zë; detyrat me shkrim; testet dhe kuize të shkurtra ditore apo përmbledhëse të udhëhequra nga mësimdhënësi; ese, punime artistike; portfolio.

Në procesin e vlerësimit të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta është e rëndësishme që mësimdhënësit, prindërit/kujdestaret, të ndërtojnë marrëdhënie pozitive, t'i motivojnë dhe inkurajojnë përpjekjet e fëmijës, të vëzhgojnë angazhimin dhe punën, të japin informata, udhëzime të qarta, të shkurtra dhe t'u japin kohë më tepër pasi që për fëmijët me nevojat të veçanta kjo është thelbësore.

6 ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË VLERËSIMIN E NXËNËSVE NË KUSHTET E PANDEMISË COVID 19

Në rrethanat e vazhimit të mësimin në kushtet e pandemisë COVID 19, kërkohet që edhe rolet për vlerësimin e nxënësve në kushtet dhe skenarët e organizimit të mësimin, të jenë të qarta dhe të përmbushen përgjegjësitë nga të gjithë bartësit e këtij procesi, si një parakusht për të arritur qëllimet e vlerësimit, duke iu referuar parimeve të vendosura në këtë udhëzues.

Role dhe përgjegjësi të veçanta në vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë COVID 19, kanë: MASH, Inspektorati i Arsimit, DKA dhe shkolla (drejtori, mësimdhënësi, nxënësi dhe prindi).

6.1 Roli i MASH

MASH ka rol udhëheqës dhe mbikëqyrës të procesit të vlerësimit të nxënësve varësisht nga cili skenar do të zhvillohet procesi mësimor për shkak të pandemisë COVID 19. Disa nga përgjegjësitë e MASH/ Divizionit për vlerësimin e nxënësve dhe Inspektoratit të Arsimit, janë si në vijim:

- ⇒ Rishikimi dhe adaptimi i politikave arsimore për vlerësimin e nxënësve, në varësi të nevojave të domosdoshme që dalin nga rrethanat e pandemisë;
- ⇒ Mbështetja e shkollave dhe mësimdhënësve me udhëzime dhe orientime të qarta për vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë, përdorimin e një platformë online për vlerësimin e nxënësve;
- ⇒ Përcaktimi i kriterëve për vlerësimin e nxënësve me nota në kushtet e organizimit të mësimin në rrethanat e pandemisë;
- ⇒ Përgatitja e formave të raportimit për vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë;
- ⇒ Zhvillimi i një programi të trajnimit për mësimdhënësit dhe mbështetja e trajnimeve të mësimdhënësve për vlerësimin e nxënësve përmes një platforme online;
- ⇒ Nxjerrja me kohë e vendimeve që lidhen me përfundimin e notave në fund të vitit shkollor dhe realizimin e vlerësimeve kombëtare (testi i Arritshmërisë, Provimi i Maturës);
- ⇒ Monitorimi i procesit të vlerësimit të nxënësve.

6.2 Roli i DKA-së

DKA ka rol mbështetës për procesin e vlerësimit të nxënësve dhe ka përgjegjësi për:

- ⇒ Informimin e shkollave lidhur me vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë COVID 19 dhe rolin e tyre;
- ⇒ Mbështetjen e trajnimit të mësimeve për vlerësimin e nxënësve;
- ⇒ Sigurimin e informacioneve për procesin e vlerësimit të nxënësve, vështirësitë, sfidat nevojat e shkollave dhe ofrimin e mbështetjes së kërkuar;
- ⇒ Raportimin në MASH për procesin e vlerësimit të nxënësve në kushtet e pandemisë COVID 19 dhe për përmbushjen e rolit të tyre në këtë proces;
- ⇒ Sigurimin e kushteve për organizimin e vlerësimit për shkallë kurrikulare dhe vlerësimeve kombëtare.

6.3 Roli i komunitetit të shkollës

Roli dhe përgjegjësitë e shkollës janë të përshkruara në dokumentet kryesore që e rregullojnë vlerësimin e nxënësve si dhe në dokumentet kurrikulare. Ato duhet të përmbushen edhe në rrethanat e organizimit të mësimin në kushtet e pandemisë COVID 19, në varësi të vendimeve dhe plotësimeve eventuale nga MASH.

6.3.1 Roli i drejtorit të shkollës

Situata e krijuar nga pandemia ka shtuar përgjegjësitë e komunitetit të shkollës në organizimin e mësimin dhe në vlerësimin e nxënësve. Në këtë proces, drejtori/eshë i/e shkollës, ka rol dhe përgjegjësi të veçantë. Ai/ajo duhet:

- ⇒ të informoj mësimeve, nxënësit dhe prindërit për vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë, rolin dhe përgjegjësitë e tyre;
- ⇒ të kujdeset për mirëqenien psiko-emociale të nxënësve;
- ⇒ të ofroj përkrahjen e nevojshme për mësimeve, nxënës dhe prindër;
- ⇒ të organizoj mekanizmat e brendshëm të shkollës (koordinatorin e cilësisë, AP, Këshillat e klasave, etj) që të koordinojnë planin e shkollës për vlerësime përmbledhëse, në mënyrë që të mos ngarkohen nxënësit me teste dhe forma të tjera të vlerësimeve për një ditë;
- ⇒ të jetë në kontakt të vazhdueshëm me mësimeve;
- ⇒ të sigurojë se të gjithë mësimeve mbajnë ditar personal për vlerësimin e nxënësve dhe mbajnë evidenca të vazhdueshme për vlerësimin dhe përparimin e nxënësve;
- ⇒ të monitorojë procesin e vlerësimit;

- ⇒ të sigurojë kushte dhe mjedis të përshtatshëm për vlerësimet përmbledhëse;
- ⇒ të përgatis formë standarde të raportimit për vlerësimin e nxënësve nga ana e mësimeve;
- të raportojë në fund të çdo periudhe mësimore dhe në fund të vitit mësimor/shkollor.

6.3.2 Roli i mësuesit/mësimdhënësit

Mësuesi/ja- mësimdhënësi, edhe në kushtet e organizimit të mësimin dhe të vlerësimit të nxënësve në rrethanat e pandemisë, **ka rol** lehtësues, udhëzues, mbikëqyrës, mentorues, këshillues, etj. Disa nga përgjegjësitë e mësuesit/mësimdhënësit në vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë COVID 19, janë si në vijim:

- ⇒ referimi për procesin e vlerësimit të nxënësve në parimet e këtij udhëzuesi;
- ⇒ kujdeset për mirëqenien psiko-emocionale të nxënësve
- ⇒ planifikon mësimdhënien dhe procesin e vlerësimit të nxënësve;
- ⇒ bashkëpunon ngushtë me kolegë dhe drejtuesit e shkollës;
- ⇒ përcakton kritere të vlerësimit, të bazuara në standardet e vlerësimit dhe i bën ato të njohura për nxënësit dhe prindërit;
- ⇒ informon nxënësit për respektimin e rregullave të sjelljes etike gjatë zhvillimit të mësimin dhe vlerësimit në kushtet e pandemisë;
- ⇒ përgatit ditarin personal të vlerësimit dhe mban në mënyrë të vazhdueshme evidenca dhe dëshmi për vlerësimin e nxënësve;
- ⇒ kryen vlerësime formuese si pjesë e vazhdueshme e procesit të të nxënësve dhe mësimdhënies, si dhe kryen vlerësime përmbledhëse, sipas orientimeve në këtë udhëzues dhe normave ligjore;
- ⇒ përfshin nxënësit në procesin e vlerësimit dhe i ndihmon ata të informohen për progresin e tyre në mësim dhe të kuptojnë çfarë pritet prej tyre;
- ⇒ vlerëson arritjet e rezultateve të nxënësve, pjesëmarrjen dhe angazhimin e nxënësve gjatë mësimin, aktiviteteve, detyrave, projekteve, punës në grupe, etj.;
- ⇒ i jep shumë rëndësi punës së pavarur të nxënësve, mendimit kritik të tyre duke i motivuar ata për vetëzhvillim;
- ⇒ u përgjigjet pyetjeve që i adresojnë nxënësit në lidhje me përmbajtjen mësimore, vlerësimin dhe përparimin e tyre në mësim;
- ⇒ siguron mjedisin e të mësuarit bashkëpunues, mjedisin e përshtatshëm për realizimin e vlerësimit;
- ⇒ informon prindërit në kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme për suksesin dhe vështirësitë e fëmijëve të tyre dhe i udhëzon ata si të ndikojnë në përmirësimin e rezultateve;

- ⇒ jep vazhdimisht sugjerime dhe komente për përmirësimin e nxënësve;
- ⇒ bën kujdes të mos i mbingarkojë nxënësit duke përdorur instrumente vlerësimi të ndryshme në të njëjtën kohë;
- ⇒ informon drejtorinë e shkollës lidhur me ecurinë e zhvillimit të mësimi;
- ⇒ përgatit raporte për vlerësimin e nxënësve në fund të çdo periudhe mësimore dhe në fund të vitit mësimor, në bazë të formës së kërkuar në nivel shkolle.

6.3.3 Roli i nxënësit

Nxënësi është pjesëmarrës aktiv në procesin e të nxënit dhe në vlerësimin e përparimit të tij/saj. Në raport me vlerësimin e në kushtet e pandemisë, secili nxënës duhet të:

- ⇒ jetë pjesëmarrës i rregullt në mësim, varësisht prej skenarit të organizimit të mësimi;
- ⇒ angazhohet aktivisht në procesin e të nxënit duke treguar përgjegjësi në zhvillimin dhe kryerjen me cilësi të detyrave;
- ⇒ ndërveprojë me bashkëmoshatarët dhe mësimdhënësit;
- ⇒ vlerësohet përmes një sërë veprimtarish të përcaktuara nga mësimdhënësi dhe në bashkëpunim me nxënës;
- ⇒ respekton rregullat dhe kriteret e vlerësimit, kontribuon në menaxhimin e vlerësimit;
- ⇒ shmanë çdo formë të kopjimit dhe abuzimit gjatë mësimi dhe procesit të vlerësimit;
- ⇒ këshillohet me mësuesin/mësimdhënësit e tij/saj për vështirësitë dhe angazhimet që duhet bërë për tejkalimin e tyre;
- ⇒ ndërmerr iniciativa për përparimin në procesin e të nxënit, të zgjidhur probleme mësimore, për të siguruar dhe për të kryer përpunimin e informacionit;

6.3.4 Roli i prindërve

Duke pasur parasysh gjendjen e krijuar për shkak të pandemisë COVID 19, prindërit duhet të përfshihen më shumë se kurrë më parë në mbështetje të fëmijëve të tyre në procesim mësimor që do të organizohet sipas skenarëve të caktuar nga shkolla si dhe në procesin e vlerësimit që do të aplikohet sipas udhëzime të MASH.

Prindërit dhe të gjithë ne duhet ta kemi prioritet mirëqenien e nxënësve. Prandaj edhe procesi i vlerësimit është planifikuar të inkurajojë nxënësit/fëmijët të mësojnë përmes angazhimeve cilësore, detyrave dhe aktiviteteve mësimore. Shkollat dhe mësimdhënësit do të ofrojnë udhëzime e sqarime për prindërit ashtu siç e kërkon situata me qëllim që progresi i fëmijëve të dokumentohet sa më mire dhe më saktë.

Çelësi i suksesit këtë vit do të jetë ajo që ka qenë çelës i suksesit çdo vit tjetër: KOMUNIKIMI. Shkolla/mësimdhënësit nuk mund të sigurojnë proces të mirëfilltë vlerësimi për nxënësit/fëmijët nëse mungon bashkëpunimi i prindërve. Prandaj, prindërit duhet të:

- ⇒ mbajnë kontakt të rregullt me shkollën;
- ⇒ kërkojnë informacione shtesë për aspektet që duhet mbështetur fëmijët e tyre;
- ⇒ informojnë shkollën lidhur me përvojat nga përcjellja/vëzhgimi i fëmijëve gjatë punës (kryerjes së detyrave dhe obligimeve) në shtëpi.

Mësimdhënësit do të planifikojnë vlerësimin e nxënësve varësit nga situata dhe nevoja e nxënësve. Është me rëndësi të kuptohet se të gjitha metodat dhe instrumentet e vlerësimit do të përshtaten me skenarin në bazë të të cilit do të zhvillohet procesi mësimor në shkolla. Prandaj, prindërit duhet të:

- ⇒ komunikojnë rregullisht me shkollën;
- ⇒ kërkojnë planin e vlerësimit të përgatitur nga mësimdhënësit;
- ⇒ sigurohen që i kuptojnë format dhe instrumentet e vlerësimit të planifikuara nga mësimdhënësit;
- ⇒ kërkojnë sqarime shtesë për vlerësimin në përgjithësi dhe rolin e tyre në këtë proces.

Prindërit duhet të vendosin disa rregulla të punës në shtëpi për fëmijët e tyre në mënyrë që detyrat dhe obligimet e dhëna nga mësimdhënësit të kryhen me kohë dhe të jenë cilësore. Prindërit duhet të monitorojnë punën e fëmijëve dhe, në bashkëpunim me mësimdhënësit, t'i ndihmojë ata për të gjetur mënyrën më të mirë për të mbështetur fëmijët e tyre. Për ta lehtësuar monitorimin dhe mbështetjen e fëmijëve të tyre në këtë proces, është me rëndësi që prindërit të:

- ⇒ caktojnë një hapësirë për punë të fëmijëve në shtëpi (aty ku ka mundësi);
- ⇒ caktojnë një orar/kohë për fëmijët e tyre për të mësuar, kryer detyrat dhe obligimet e dhëna nga mësimdhënësi;
- ⇒ sigurohen që detyrat dhe obligimet ditore janë raportuar/dërguar te mësimdhënësi në kohën e caktuar.

Roli i prindërve është të inkurajojnë fëmijët për të kryer të gjitha detyrat në mënyrë të pavarur, të këshillohen me mësimdhënësit e vet gjatë orëve të mësimin në klasë dhe punës në shtëpi – online/në distanca – përmes platformës që ka zgjedhur shkolla. Prandaj, prindërit duhet të:

- ⇒ informohen për platformën e punës/komunikimit që do të përdoret nga shkolla;
- ⇒ kërkojnë ndihmë dhe udhëzime për përdorim të saj;
- ⇒ përkrahin fëmijët në kryerje të obligimeve/detyrave në shtëpi, gjithsesi jo duke kryer detyrat në vend të fëmijëve.

Udhëzimet specifike për format e vlerësimit të fëmijëve, metodat dhe instrumentet i gjeni në kapitujt 3, 4, 5 dhe 6 të këtij udhëzuesi.

Siç mund të kuptohet nga ky Udhëzues dhe nga informatat tjera deri më tani, MASH, DKA dhe shkollat janë duke bërë përgatitje që procesi mësimor në kushte të pandemisë COVID 19 të zhvillohet sa më mirë. Pa marrë parasysh skenarin në bazë të të cilit do të zhvillohet procesi mësimor, nga nxënësit/fëmijët do të kërkohej më shumë punë e pavarur në shtëpi. Prandaj, roli i prindërve për të siguruar kushte sa më të mira për punë në shtëpi është më i nevojshëm se kurrë më parë.

Në këtë kontekst, do të ishte ndihmë e madhe të siguroni pajisjen teknologjike të cilën fëmija juaj do ta përdor rregullisht gjatë këtij viti shkollor. Kjo do ta lehtësonte të mësuarit e fëmijës, qasjen në informata online (nga shkolla/mësimdhënësi apo tjera), si dhe mbështetë procesin e vlerësimit duke ofruar mundësi të lehtë për ruajtjen e dëshmive mbi punën në

shtëpi dhe komunikimin me mësimdhënësit. Gjithsesi, është e ditur se kjo kërkesë varet nga faktorë tjerë të cilët shkolla/mësimdhënësi nuk i kanë nën kontroll, mirëpo ju si prindër mund të kërkon mbështetje nga Këshilli drejtues i shkollës, DKA, MASH dhe donatorë.

6.4 Monitorimi dhe raportimi për vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë COVID 19

Monitorimi dhe raportimi për organizimin e mësimit dhe vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë bëhet në nivel të shkollës, DKA dhe MASH- Inspektoratit të Arsimit. Nga cilado hallkë institucionale që monitoron procesin mësimor dhe procesin e vlerësimit të nxënësve, aspektet kryesore që duhet të jenë në fokus të monitorimit të vlerësimit duhet të jenë si në vijim:

- ⇒ Informimi i mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve për procesin e vlerësimit;
- ⇒ Kujdesi për mirëqenien psiko – emocionale të nxënësve;
- ⇒ Referimi në parimet e këtij udhëzuesi dhe në rregullativën ligjore;
- ⇒ Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit dhe informimi i nxënësve dhe prindërve;
- ⇒ Aspektet që lidhen me përcaktimin e metodave dhe formave të vlerësimit, argumentet kryesore për përzgjedhjen e metodës/ave të vlerësimit;
- ⇒ Aspektet që lidhen me zhvillimin i instrumenteve të vlerësimit dhe rezultatet e vlerësimit;
- ⇒ Angazhimin e nxënësve, kryerjen e detyrave të mësimit dhe cilësinë e tyre;
- ⇒ Ditarët e klasës dhe notat e vendosura në ditar;
- ⇒ Mbajtja e evidencave të vlerësimit të nxënësve nga ana e mësimdhënësve;
- ⇒ Argumentimi i notave vlerësuese;
- ⇒ Krahësimi i notave vlerësuese dhe rezultateve ndërmjet periudhave mësimore, për të gjykuar për përparimin e nxënësve dhe besueshmërinë e procesit dhe të rezultateve të vlerësimit;
- ⇒ Raportimi i vlerësimit, në mënyrë të veçantë për nxënësit dhe prindër.

Si nga shkolla, ashtu edhe nga DKA dhe MASH- Inspektoratit të Arsimit, në kuadër të monitorimit të vlerësimit të nxënësve në kushtet e pandemisë COVID 19, mund të organizohen pyetësorë ose biseda me nxënësit, mësimdhënësit, prindër për të monitoruar vlefshmërinë e procesit të vlerësimit, nevojat dhe mënyrat përmes të cilave mund të mbështeten dhe përkrahen, për të parë nëse nxënësit ndihen të motivuar nga vlerësimi i organizuar nga mësimdhënësit e tyre, etj.

Raportimi për vlerësimin e nxënësve gjatë organizimit të mësimit në kushtet e pandemisë COVID 19, duhet të jetë pjesë përbërëse e raportimeve për rrjedhën e ecurisë së procesit mësimor dhe të skenarëve në bazë të cilëve organizohet mësimi.

Të rëndësishme të veçantë konsiderohen raportet e mësimdhënësve për nxënësit dhe për prindër mbi pjesëmarrjen e rregullt të nxënësit në mësim, angazhimin në kryerjen e detyrave dhe cilësinë e realizimit të detyrave, aktivizimin gjatë zhvillimit të mësimit, progresin dhe arritjet e nxënësve, mundësitë dhe nevojat për të mbështetur përparimin e secilit nxënësit.

Raportimi i mësimdhënësve për nxënës dhe prindër duhet të identifikojë përparimin dhe dobësitë e nxënësve në mësim, përshkrimin dhe argumentimin e tyre, si dhe të theksoj veprimet/masat që duhet ndërmarrë për përmirësimin dhe avancimin e arritjeve në mësim. Pra, raportimi nga ana e mësimdhënësve duhet të ketë disa specifika, si:

- ⇒ të jetë me gojë ose me shkrim;
- ⇒ të jetë konstruktiv dhe pozitiv;
- ⇒ të identifikojë çfarë ka bërë nxënësi mirë dhe jo mirë, aspektet sfiduese;
- ⇒ çfarë duhet bërë dhe si duhet bërë për përmirësim dhe avancim;
- ⇒ çfarë duhet të marrë përgjegjësi nxënësi, prindi dhe vetë mësimdhënësi për mbështetje shtesë të nxënësit/es në përparimin e tij/saj.

Mësimdhënësit, ashtu si gjatë procesit të mësimit dhe të vlerësimit, edhe në raportimin për vlerësimin dhe përparimin e nxënësit/es, duhet të tregojnë kujdes për kategoritë e cenueshme, nxënësit me nevoja të veçanta. Raportimi për këto raste të përshkruaj një balancë midis arritjeve dhe aspekteve sfiduese.

Hierarkia e raportimit që duhet respektuar:

- ⇒ Mësimdhënësi – bën raportim për nxënësit dhe prindërit, dhe merr informata kthyes;
- ⇒ Mësimdhënësi bën raportim në aktivet profesionale dhe udhëheqje të shkollës;
- ⇒ Kryetarët e aktiveve profesionale dhe këshillave të klasës bëjnë raporte në nivel të aktivitetit dhe të udhëheqjes së shkollës;
- ⇒ Drejtorët e shkollave raportojnë para këshillit të mësimdhënës dhe Këshillit drejtues të shkollës, DKA-s, MASH/Inspektoratit të Arsimit;
- ⇒ DKA-të raportojnë në MASH/Inspektoratin e Arsimit dhe Departamentet përkatëse, si dhe në organet e shkollës;
- ⇒ Inspektorati i Arsimit raporton ministrin e Arsimit dhe përgatit raporte informimi për Departamentin e arsimit parauniversitar, divizionin e kurrikulave dhe divizionin e vlerësimit.

Raportimi në nivel institucional duhet të jetë i rregullt dhe i veçantë për rastet kur ka nevojë. Raportimi institucional duhet të përfshijë:

- ⇒ Aspektet që janë monitoruar në raport me vlerësimin e nxënësve;
- ⇒ Përparësitë dhe dobësitë e identifikuara, përshkrimi dhe argumentimi i tyre;
- ⇒ Mundësitë e përmirësimit, thekse orientuese të mbështetura me shembuj dhe praktika të mira;
- ⇒ Nevojat për përmirësim, përshkrimi të theksoj se kush duhet të angazhohet për të plotësuar nevojat e ngritura;
- ⇒ Rekomandime të tjera.

SHTOJCA

Një shembull për planifikim të vlerësimeve në vitin shkollor 2020/21

Fusha lëndore	Niveli i arsimit/ Klasa	Qëllimi i vlerësimit	Përdorimi i vlerësimit	Datat e realizimit të vlerësimit	Raportimi i rezultateve- shkollë/ nxënës/ prindër
------------------	-------------------------------	----------------------	---------------------------	--	---